



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në**

**“Menaxhim Infermieror”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**Kolegji Universitar “REALD”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Vjollca Durro
2. Dr. Niko Hyka

Janar/2020

## **PËRMBAJTJE**

SHKURTIME.....	3
Përmbledhje e vlerësimit të jashtëm.....	4
Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm.....	5
Përmbledhje e pasqyrimet ose jo të komenteve të institucionit ndaj draft-raportit të programit të studimit .....	6
Shkalla e përmbushjes së rekomandimeve nga akreditimi i parë.....	11
<b>I. VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL NË “MENAXHIM INFERMIEROR”.....</b>	<b>13</b>
<b>1. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT .....</b>	<b>13</b>
<b>2. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER PROFESIONAL.....</b>	<b>20</b>
<b>3. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT .....</b>	<b>33</b>
<b>4. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT .....</b>	<b>47</b>
<b>5. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE .....</b>	<b>55</b>
<b>6. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL .....</b>	<b>64</b>
<b>II. PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL NË “MENAXHIM INFERMIEROR”, TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, KOLEGJI UNIVERSITAR “REALD” .....</b>	<b>72</b>
<b>III. SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT .....</b>	<b>78</b>
<b>IV. LISTA E EVIDENCAVE MBËSHTETËSE .....</b>	<b>79</b>

## SHKURTIME

- KUR Kolegji Universitar “REALD”
- FSHM Fakulteti i Shkencave Mjekësore
- DSHTM Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore
- MPMI Master Profesional Menaxhim Infermieror
- BADM Bordi i Administrimit KUR
- SA Senati Akademik
- ASCAL Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
- GVB Grupi i Vlerësimit të Brendshëm
- BA Bordi i Akreditimit
- VBA Vendim i Bordit të Akreditimit
- VKM Vendim i Këshillit të Ministrave
- ZBNJ Zyra e Burimeve Njerëzore
- RVB Raport i vlerësimit të brendshëm
- RSH Republika e Shqipërisë
- NJSBC Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- MASR Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
- KSH Kërkim Shkencor

## **Përmbledhje e vlerësimit të jashtëm**

Kolegji Universitar "REALD"(KUR) është një institucion privat i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011, si Akademia e Studimeve të Aplikuara "REALD". Në vitin 2017 është riorganizuar duke marrë emrin Kolegji Universitar "REALD".

Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 93, datë 20.10.2017, me kohëzgjatje 5 vite akademike e vlefshme deri më deri në 19/10/2022.

KUR përbëhet nga 2 njësi kryesore, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Secili fakultetet përbëhet nga 3 njësi bazë, si vijon:

*Fakulteti i Ekonomisë:* Departamenti i Financës, Departamenti i Menaxhimit dhe një Qendër Kërkimore;

*Fakulteti i Shkencave Mjekësore:* Departamenti i Farmacisë, Departamenti i Stomatologjisë dhe Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore.

KUR, për vitin akademik 2018-2019, ka pasur aktive 12 programe studimi në total, nga të cilat 2 programe 2 vjeçare, 5 programe Bachelor, 2 programe të integruara studimi, 1 program Master i Shkencave dhe 2 programe Master Profesional. Numri total i studentëve për vitin akademik 2018-2019 ka qenë 456 studentë.

Programi i studimit Master Profesional në "Menaxhim Infermieror" është hapur me UMASH Nr. 336, datë 13.08.2012, me 90 kredite dhe kohëzgjatje 1.5 vite akademike (bazuar në VKA Nr. 346, datë 13.07.2012). Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Ky program është akredituar për herë të parë me rekomandime me UMASH Nr. 327, datë 15.08.2013, mbështetur në VKA Nr. 512, datë 18.07.2013.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm**

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” (MPMI), i ofruar nga Kolegji Universitar “REALD”, (KUR). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të dytë për Masterin Profesional, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al] Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e vlerësimit [ascal.al] të miratuar nga ASCAL/BA dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga ASCAL sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 93 ditë nga data 04.07.2019 deri në 20.12.2019 [afatet e vlerësimit].

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof.As. Vjollca Durro dhe Dr. Niko Hyka. Koordinatorë Teknikë e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Ersi Dako.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në KUR e zhvilluar në datat 21 dhe 22 tetor 2019. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e KUR.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion. Ndërkohë një angazhim i tillë nuk është vërejtur gjatë fazës së përgatitjes së RVB dhe dokumentacionit mbështetës pasi sikundër evidentohet në vijim, raporti i vlerësimit të brendshëm dhe evidencat nuk janë hartuar dhe përgatitur sipas udhëzimeve të ASCAL.

Gjithashtu, GVB falenderon ASCAL dhe Koordinatorin Teknik për mënyrën e menaxhimit dhe korrektësinë e treguar gjatë gjithë procesit.

Më datë 23.12.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 123/18 Prot., dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 13.01.2020, përmes sistemit AMS, dërgohet shkresa zyrtare e Institucionit, me Nr. 04 Prot., datë 08.01.2020, me lëndë *“Kundërshtime rreth Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”*.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportit, shprehet si vijon:

#### **Përmbledhje e pasqyrimit ose jo të komenteve të institucionit ndaj draft-raportit të programit të studimit**

Në vijim të procesit të akreditimit të programit të studimit, institucioni ka dërguar komentet mbi gjetjet, konstatimet dhe gjykimet e paraqitura në draftin e raportit për programin e studimit MP. *“Menaxhim Infermieror”*. Bazuar në procedurën e akreditimit, grupi i vlerësimit analizoi me seriozitet konstatimet e bëra nga institucioni dhe në vijim ka dhënë gjykimin e tij mbi reflektimin ose jo në versionin përfundimtar të raportit të vlerësimit të jashtëm.

Së pari, duhet theksuar që komentet e institucionit kryesisht janë mendime dhe opinione mbi plotësimin e standardit ose komente mbi konstatimin e GVJ. Komentet nuk janë bërë mbi gjetjen e GVJ, por mbi standardet, të cilat po ashtu, në shumicën e rasteve, nuk janë cituar sikundër janë paraqitur në raport. Citimi jo i saktë i konstatimit nga RVB, mosreferimi i dokumenteve respektive, e bën të paqartë kundërshtimin e institucionit dhe arsyet përkatëse.

Gjithsesi, në funksion të procesit dhe për të sqaruar çdo paqartësi në lidhje me marrjen në konsideratë ose jo të komenteve të IAL, GVJ, ka paraqitur për çdo koment të IAL, argumentin përkatës dhe vendimin përfundimtar mbi marrjen ose jo në konsideratë të komentit të IAL si dhe reflektimin përfundimtar në RVJ:

### **1. Komenti i IAL:**

*Shkalla e përmbushjes së rekomandimeve nga akreditimi i parë. Në draft-raport është vlerësuar se “Përmbushet pjesërisht”, me argumentimin se “nuk janë plotësuar kriteret e pranimit të studentëve në këtë program”.*

### **Përgjigja e GVJ:**

Konstatimi i IAL nuk është i saktë. GVJ në paragrafin 3, ka dhënë vlerësim për çdo rekomandim të lënë nga akreditimi i mëparshëm. Gjykimi është bazuar në dokumentat e cituara dhe nga informacioni i marrë në institucion. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ evidenton se IAL është bazuar në të njëjtin dokument [plotësimi i rekomandimeve]. Ky informacion është jo i plotë dhe i pa mbështetur në plan veprim dhe evidenca. Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.

### **2. Komenti i IAL:**

*Standardi I.1. “Zhvillimet në tregun global të punës, dhe zhvillimet e shkencës dhe teknologjisë”*

### **Përgjigja e GVJ:**

Konstatimi i IAL është i pasaktë. Standardi I.1 shprehet: *Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.* Përmbushet kryesisht, ndërsa standardi I.2, ku përfshihet një pjesë e rekomandimit të sipërcituar, përmbushet kryesisht, sepse GVJ ka identifikuar 4 pika të dobëta në 4 kriteret e këtij standardi. Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.

### **3. Komenti i IAL:**

*Standardi I.2. Nga GVJ është vlerësuar “Përmbushet pjesërisht”, duke rekomanduar që “Të kryhen ndryshimet e nevojshme në strategjinë e zhvillimit dhe të përshtatet me statusin aktual të KUR, qëllimin dhe objektivat që ka ky institucion”.*

### **Përgjigja e GVJ:**

GVJ ka deklaruar se institucioni ka një strategji zhvillimi, por e cila nuk reflekton kërkesat e kriterëve në përbërje të standardit të mësipërm. Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.

### **4. Komenti i IAL:**

*Standardi I.3. “Mbi nevojat dhe kërkesat e tregut të punës”.*

### **Përgjigja e GVJ:**

Edhe pse institucioni nuk ka paraqitur studim ose analizë të tregut rajonal të punës, atij kombëtar apo ndërkombëtar, nisur nga deklaratimet e drejtuesve, kontakte dhe informacione merren në mënyrë të drejtpërdrejtë kryesisht për rajonin e Vlorës dhe Fierit. Është reflektuar ndryshimi, standardi II.4, faqe 28.

### **5. Komenti i IAL:**

*Standardi I.5. "Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit".*

### **Përgjigja e GVJ:**

Standardi I.5 ka në përbërje të tij 6 kritere, për të cilat janë evidentuar 5 problematika që lidhen me mos funksionimin e drejtë të njësive bazë, paqëndrueshmëri të personelit, dokumentim të veprimtarive, analizë të bashkëpunimeve, etj. Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.

### **6. Komenti i IAL:**

*Standardi II.2: Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.*

### **Përgjigja e GVJ:**

Në aktet ligjore në fuqi është përcaktuar se në procesin e mësimdhënies duhet të përfshihet personel akademik me tituj dhe grada shkencore. Referuar të dhënave në evidencen 19.1 "Struktura akademike e departamentit 2018-2019", evidenca Nr. 4 "Ngarkesa mësimore në program" dhe evidencën nr 2 "Stafi i programit", ka mospërputhje lidhur me angazhimin e stafit akademik si staf akademik efektiv dhe staf akademik me kontrate. Psh. personi V.P dhe V.H, në evidencën nr. 19 dhe nr. 2 figurojnë PAK, ndërsa në evidencën nr. 4 figurojnë PAE. Personi S.V., në evidencën nr. 19 dhe evidencën nr. 2 figuron PAE, në evidencën nr. 4 PAK etj. Referuar këtyre mospërputhjeve, GVJ, sikundër është shprehur edhe në raport, nuk mund të llogarisë raportin PAE/PAK si dhe ngarkesën mësimore që mbulohet prej tyre. Edhe në listëpagesën e sigurimeve, ka mospërputhje me personelin e deklaruar. Moshë e stafit akademik dhe titujt apo gradat shkencore që duhet të kenë stafi akademik për tu angazhuar në mësimdhënie, janë të përcaktuar qartë në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.

### **7. Komenti i IAL:**

*Standardi II.3. Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.*

### **Përgjigja e GVJ:**

Referuar dokumentacionit të KUR, në organizimin e programit mësimor nuk është ruajtur raporti në % i shpërndarjes së veprimtarive formuese në kategori të veçanta sipas përqindjes së përcaktuar në VKM 41 datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe mungon kategoria D, ka lëndë që nuk janë reflektuar ndryshimi i krediteve në ECTS sipas dokumentit të miratuar, mospërputhje të numrit të ECTS të këtij programi studimi me numrin e ECTS/orëve mësimore të deklaruar në syllabuset e planit mësimor, mungesë të syllabuseve etj. (referojuni për hollësi RVJ, standardi II.1). Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.



#### **8. Komenti i IAL:**

*Standardi III.7. Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.*

#### **Përgjigja e GVJ:**

Në takimin me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se kanë si objektiv realizimin e programeve të përbashkëta me institucione jashtë vendit si Italia, për të cilat kanë rënë dakord parimisht por nuk janë zhvilluar për çështje burokracie pasi po organizojnë zgjedhje në institucionet e tyre. Për këtë shkak, KUR nuk ka kuota të miratuara në programin BSc. Infermieri në vitin e parë 2019-2020. Pra behet fjalë për marrëveshjet në fushën e këtij programi studimi.

GVJ, përveç konstatimeve lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit, në këtë standard ka paraqitur dhe konstatime të tjera referuar kërkesave të standardit (referencë konstatimet RVJ Standardi III.7). Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.

#### **9. Komenti i IAL:**

*Standardi IV.5. Ky standard nga GVJ është vlerësuar “Përmbushet pjesërisht”. GVJ në draft-raport ka cituar se “Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni nuk ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullores të sipërcituar”.*

#### **Përgjigja e GVJ:**

Referuar standardit IV.5 dhe kriterëve në përbërje të tij rezulton se në përmbushje të këtij standardi, IAL nuk ka vënë në dispozicion të GVJ informacione, manuale të sistemit, listën e funksioneve dhe shërbimeve që kryen sistemi, aksesin në të, përdorimet në procese të ndryshme në menaxhimin e institucionit, etj. Për më tepër, nga takimi me sekretarinë mësimore u theksua se të dhënat mbahen në Excel, studentët dhe stafi nuk kanë asnjë informacion mbi përdorimin e sistemit, mënyrën e gjenerimit të dokumenteve, procesverbaleve etj. të cilat dëshmojnë se veprimtaritë nuk menaxhohen nëpërmjet një sistemi elektronik menaxhimi. GVJ, ka theksuar se Institucioni ka një rregullore të menaxhimit të informacionit, faqe interneti, e-maile por lidhur me sistemin e menaxhimit, raporti nuk ndryshon.

#### **10. Komenti i IAL:**

*Standardi IV.6. Ky standard nga GVJ është vlerësuar “Përmbushet pjesërisht”.*

#### **Përgjigja e GVJ:**

Standardi IV.6 “Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve”. Institucioni ka evidenca financiare që i ka vënë në dispozicion, por këto nuk janë për tre vitet e fundit. Gjithashtu, siç jemi shprehur edhe në raport, GVJ konstatoi se në dokumentet e vëna në dispozicion të këtij procesi [raporti financiar vjetor],

[plan financimi], jepen të dhëna financiare të detajuara në lidhje me aktivitetin e shoqërisë, shpenzime operative, por informacioni nuk është përmbledhur në formën e një raportimi analitik në funksion të realizimit të aktivitetit akademik për institucionin dhe programin e studimit. Nuk ka informacion të detajuar për shpërndarjen e fondeve sipas zërave të caktuar. Në raportin financiar të paraqitur mungon një pasqyrë e hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Për sa më sipër, raporti nuk ndryshon.

## Shkalla e përmbushjes së rekomandimeve nga akreditimi i parë

Programi i studimit MPMI është akredituar në vitin 2013 me UMASH Nr. 327, datë 15.08.2013, mbështetur në VKA Nr. 512, datë 18.07.2013.

Bazuar në Vendimin e Këshillit të Akreditimit, rekomandimet e lëna nga ky proces janë:

1. Të bëhet më shumë përpjekje për rritjen e numrit të studentëve dhe në përmirësimin e nivelit të kontingjentit të studentëve të pranuar.
  2. Të përmirësohet numri i personelit akademik efektiv në drejtimin e infermieristikës.
  3. Të ndërtohen laboratorë në nivelin që kërkon programi i studimit.
  4. Të pasurohet biblioteka me botime të fushës së mjekësisë si dhe ndërtohet një librari on-line.
- 
1. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ evidenton se institucioni ka paraqitur një dokument në lidhje me plotësimin e rekomandimeve të mësipërme **[plotësimi i rekomandimeve]**. Ky informacion është jo i plotë dhe i pa mbështetur në plan veprim dhe evidenca. Informacioni i paraqitur nuk është reflektuar në raportin e vlerësimit të brendshëm. Në kushtet e mungesës së informacionit të plotë për të gjykuar mbi shkallën e plotësimit të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm, GVJ, bazuar edhe në informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion, evidenton si më poshtë: Bazuar në listën e studentëve të vënë në dispozicion **[lista e studentëve 12-19]** dhe gjatë takimit me studentët **[T3-takimi me studentë]** rezultoi se ka një rritje të studentëve që studiojnë në programin e studimit dhe GVJ konstatoi se nuk ka aplikuar kritere përzgjedhëse të pranimit të tyre në program. Nga GVJ, **ky rekomandim konsiderohet pjesërisht i plotësuar.**
  2. Plotësimi i rekomandimit për personelin akademik në programin e studimit MPMI ende mbetet një sfidë për KUR. Referuar të dhënave të vëna në dispozicion gjatë vizitës në institucion rezultoi se personeli akademik me kohë të plotë nuk përmbush kriteret ligjore për sa i përket titujve, gradave dhe kualifikimeve **[cv e stafit]**, **[lista e personelit]**, **[list-pagesa e sigurimeve shoqërore]** **[fusha e vlerësimit 4]**. Nga të dhënat e deklaruara nga IAL dhe të vëna në dispozicion nga ASCAL është evidentuar se një pjesë e personelit akademik me kohë të plotë me tituj e grada dhe që mbajnë edhe poste drejtuese, ushtrojnë detyrën e tyre jo në përputhje me nenin 65 të LAL “Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik”. GVJ u njoh me përpjekjet e institucionit për të rekrutuar personel të ri akademik dhe mirëkupton vështirësitë që hasen për punësimin e personelit të kualifikuar, por institucioni duhet të vazhdojë përpjekjet dhe të gjejë mekanizmat e duhur për të rekrutuar personel të kualifikuar në të ardhmen për të mundësuar ofrimin e programit të studimit në përputhje me standardet dhe kriteret e cilësisë. Nga sa më sipër, GVJ gjykon se **rekomandimi është përmbushur pjesërisht.**
  3. GVJ u njoh nga afër me përpjekjet e institucionit për përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe evidentoi dymanekinetë pajisur për simulime nga studentët e programit të studimit. Referuar numrit të studentëve, ato janë të mjaftueshme, prandaj **ky rekomandim konsiderohet i plotësuar.**

4. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u njoh nga afër me bibliotekën e institucionit. Fondi i teksteve për fushën e mjekësisë nuk është në nivelin e duhur. Për shkak të natyrës specifike që ka fusha e mjekësisë për botime të reja të viteve të fundit dhe faktit që aksesii nevojshëm në libraritë on-line<sup>1</sup> sipas rekomandimit të dhënë nuk është realizuar nga ana e institucionit, ky rekomandim **konsiderohet i plotësuar pjesërisht [33 Lista e teksteve në bibliotekë].**

---

<sup>1</sup>GVJ e ka të paqartë kushtin e vendosur për krijimin e librarisë on – line dhe e ka konsideruar si krijimin e mundësive për akses në libraritë – online.

# I. VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL NË “MENAXHIM INFERMIEROR”

## 1. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

<b>Standardi I.1</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Kolegji Universitar “REALD” (KUR) është një institucion jopublik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr. 93, datë 20.10.2017 për një afat 5 vjeçar, deri më deri në 19/10/2022. Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit [T1, takimi me drejtuesit]. Bazuar në statutin dhe rregulloren e IAL [statuti KUR, [rregullore e përgjithshme KUR], programet e ofruara nga KUR synojnë përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e kolegjit [www.asc.al, numri i programeve]. KUR ka fokusuar veprimtarinë e tij në dy drejtime kryesore, atë të shkencave ekonomike dhe mjekësore dhe në këtë kuadër edhe programet janë në këto drejtime studimi.			
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sipas deklarimeve të drejtuesve, programet e studimit të ofruara nga KUR bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka rajoni dhe vendi. Nga analiza e dokumentacionit, GVJ, nuk evidentoi raste konkrete studimi që kanë orientuar hapjen dhe zhvillimin e programeve në tërësi apo këtë program studimi në veçanti. Bazuar në deklaratimet e drejtuesve, kjo realizohet nga takime të drejtpërdrejta.			
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar edhe strategjisë së zhvillimit të KUR [strategjia e zhvillimit 16 – 21], e cila rezulton të jetë e pa përditësuar pas riorganizimit të institucionit, GVJ nuk identifikon informacione mbi strategjinë e institucionit për zhvillimin e programeve të studimit që janë në të njëjtën linjë me zhvillimet social-ekonomike të vendit, shëndetësisë apo politikave rajonale të Qarkut të Vlorës (Standardi I.1).			
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Institucioni ka hartuar një strategji zhvillimi para ndryshimit të statusit nga akademi në kolegji (Strategjia e Akademisë Reale 2016-2021)[ <b>strategjia</b> ]. <i>GVJ vëren se në këtë strategji, institucioni nuk ka të përcaktuara qartë drejtimet strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të jenë në përputhje me fushën e veprimtarisë së KUR.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstron se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Për këtë arsye, <b>GVJ rekomandon të kryhen ndryshimet e nevojshme në strategjinë e zhvillimit dhe të përshtatet me statusin aktual të KUR, qëllimin dhe objektivat që ka ky institucion (Standardi I.2).</b> Statuti i KUR është miratuar me Urdhër Nr. 147, datë 31.03.2017, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Rregullorja e përgjithshme është miratuar me Vendim Nr. 19, datë 01.08.2017 të Senatit Akademik. KUR ka hartuar dhe miratuar edhe rregulloret e njësisë dhe strukturave të tjera [ <b>rregullore e fakultetit, rregullore NJSBC, rregullore e sekretarisë, rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, etj.</b> ]. <i>GVJ vë re se disa nga këto akte rregullatore mbartin gabime dhe mbivendosje kompetencash. Për më tepër, evidentohen referenca nga legjislacioni i mëparshëm ose informacione të institucionit para riorganizimit. Në këtë kuadër GVJ rekomandon të rishikohen dhe përditësohen aktet e brendshme rregullatore të kolegjit në përputhje me Statutin dhe LAL 80/2015 (Standardi I.2).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<i>Programet e studimit të ofruara nga institucioni janë në përputhje me fushën e veprimtarisë së IAL dhe dy drejtimet kryesore që ai ofron, shkencë ekonomike dhe mjekësore [<b>lista e programeve FSHM</b>]. Programet e studimit të ofruara nga institucioni janë hapur në fazë të ndryshme të funksionimit të tij. <i>GVJ nuk identifikoi të dhëna apo studime të mirëfillta dhe propozime për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. Megjithatë, gjatë takimeve të zhvilluara [<b>T1 takimi me drejtuesit</b>] GVJ u informua që personeli akademik apo drejtuesit vazhdimisht informohen në rrugë të ndryshme mbi nevojat e tregut të punës, kryesisht në Qarkun e Vlorës, Fierit, etj. Drejtuesit e fakultetit dhe personeli shprehen se organizimi i programit përmbush kërkesat që kanë vendet e tjera pasi janë punësuar në vende të ndryshme të Bashkimit Europian [<b>T1-takimi me drejtuesit, T5 - takimi personeli</b>].</i></i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	<b>GVJ propozon që përditësimet në Strategjinë e zhvillimit të kolegjit, të marrin në konsideratë nevojat e rajonit të Vlorës,</b>

	zhvillimet në tregun global të punës dhe zhvillimet e shkencës dhe teknologjisë (Standardi I.1).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nat	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit paraqet në mënyrë përmbledhëse objektivat e tij [dosja programit].</p> <p>Bazuar në këto objektiva, programi synon të përgatisë profesionistë të infermieristikës të aftë profesionalisht të punojnë në sektorin publik dhe atë privat të shëndetësisë. <i>Sikundër u theksua më sipër, programi nuk ka një studim të qartë mbi nevojat e tregut nga të cilat të nxirren edhe objektivat e programit.</i></p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ identifikoi se personeli akademik dhe drejtuesit, në mënyra të ndryshme, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në rajonin e Vlorës dhe i reflektojnë ato në përmbajtje të programit.</p> <p>GVJ rekomandon që njësisia kryesore (FSHM) të kryejë një studim të përgjithshëm mbi nevojat e tregut në lidhje me programet që ofron (ku të përfshihet dhe programi MP.MenaxhimInfermieror). Të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme, përfshirë edhe studentët e diplomuar, të analizohen dhe të hartohet një dokument analitik me propozime konkrete në kuadër të përmirësimit të programit/eve të studimit (Standardi I.3). Mbi rezultatet e këtij studimi të mbështeten edhe ndryshimet/përmirësimet në programin e studimit.</p> <p><i>Programi i studimit nuk është organizuar në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” e për këtë arsye objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, që matin rezultatet e pritshme të të nxënit, që garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut e që mundësojnë punësimin e shpejtë të studentëve, nuk janë pasqyruar.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p><b>Organizimi i planit mësimor në numër të madh lëndësh/modulesh [plani], pa reflektuar ndryshimet që lindin nga VKM e sipërcituar, si në organizimin e veprimtarive formuese dhe kategoritë, komponentët</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formuese struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i</p>	

<p>përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p><b>mësimore dhe përqindjen respektive të secilit komponent, nuk mundëson përafrim të programit me programe të tjera në vend e më gjerë. Edhe në takimet me drejtuesit dhe personelin akademik, nuk u qartësua metodologjia e ndërtimit të kurrikulës dhe përafrimi i saj me programe të ngjashme në vend apo me institucione ndërkombëtare.</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Punësimi i studentëve brenda vendit apo në vende të tjera është tregues që programi ka elementë të rëndësishëm që ndikojnë në formimin profesional të tij, veçanërisht komponentin praktik.</p> <p><b>GVJ rekomandon të riorganizohet programi i studimit në përputhje me Udhëzimet e MASR dhe VKM 41.</b> Për më tepër, brenda hapësirës ligjore, të merren në konsideratë edhe orientimet që dalin nga Direktiva 2005/36/EC dhe Direktiva 2013/55/EU e Bashkimit Europian për programet e studimit në fushën e Shkencave infermiore (Standardi I.3).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Një nga komponentët më të rëndësishëm të programit është praktika profesionale. Pasja e një numri të vogël studentësh, jep mundësi të praktikimit të njohurive në qendrat shëndetësore rajonale. GVJ e konsideron realizimin e praktikave profesionale si praktikë të mirë nga ana e institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u evidentua që <i>orët e praktikës profesionale të paraqitura në planin mësimor nuk përkrijnë me orët e praktikës që studentët realizojnë</i> (nga takimi me studentët rezultojnë se ata bënin më shumë, çka konsiderohet pozitive).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p><b>Por, me riorganizimin e programit dhe planit mësimor, këto orë të reflektohen në përmbajtje të tij.</b></p> <p>Bazuar në objektivat që ka programi dhe në planin mësimor, nuk u evidentuan elementë të mësimdhënies në gjuhë të huaj apo module të veçanta të programit. Në takimet në IAL u theksua fakti i lidhjes së marrëveshjes së KUR me disa institucione arsimore italiane [<b>marrëveshjet ndërkombëtare</b>] dhe përfshirja e personelit të huaj në programet e studimit. Për programin MPMI nuk u evidentuan raste të tilla [<b>lista e stafit</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>				
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		



**Standardi I.4**

**Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>KUR është licensuar fillimisht si Akademia e Shkencave të Aplikuara “Reald”. Institucioni ka një eksperiencë disa vjeçare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë (licensuar me VKM Nr. 650, datë 14.09.2011 dhe akredituar me VBA Nr. 93, datë 20.10.2017 me kohëzgjatje 5 vite akademike), çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon <b>[T7-vizita e ambienteve]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe qëndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet dhe burimet financiare e logjistike që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit <b>[takimi me bordin e administrimit, financa]</b>, <b>[T7-vizita në ambientet e KUR]</b>.</p> <p>GVJ e konsideron praktikë të mirë infrastrukturën që disponon institucioni dhe përpjekjet për pajisjen e laboratorit të infermieristikës me pajisjet e duhura laboratorike (dy manikinesimulative) të cilat ndihmojnë në praktikimin e njohurive të marra nga studentët.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p><i>Megjithatë, GVJ evidentoi problematika përse i përket kapaciteteve akademike ku shumica e lëndëve/moduleve mbuloheh kryesisht nga personel me kohë të pjesshme ose personel që mbulojnë numër të madh lëndësh/modulesh <b>[lista e stafit],[cv e stafit] (shih fushën 2 dhe 4).</b></i></p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore i cili në total ofron 8 programe të ciklit të parë dhe të dytë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Bachelor në “Infermieri”;</li> <li>– Bachelor në “Fizioterapi”;</li> <li>– Bachelor në “Teknik Laboratori në Mjekësi”;</li> <li>– Program i integruar “Master i shkencave” në “Stomatologji”;</li> <li>– Program i integruar “Master i shkencave” në “Farmaci”;</li> <li>– “Master profesional” në “Menaxhim Infermieror”;</li> <li>– “Master profesional” në “Fizioterapi”;</li> <li>– Program profesional (2 vjeçar) në “Ndihmës dentar”.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantoheh nga institucionet partnere.</p>	<p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore <b>[lista programet FSHM]</b>.</p> <p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me</p>

	<p>atë të programit të studimit. <i>Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit ende nuk është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane pasi nuk është finalizuar korniza nënligjore e cila udhëzon institucionet se si duhet kryer ky proces.</i></p> <p>Niveli i njohurive që ofron programi përkon me atë të nivelit 7 të KSHK / EQF [dosja e programit].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjëseve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Kolegji Universitar “REALD” është një institucion jopublik relativisht i vogël përse i përket numrit të studentëve por jo në numër programesh që ofron [lista e programeve]. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon.</p> <p>Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit [T1-takimi me drejtuesit], bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. Disa anëtarë të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose në komisione të ngritura për tematika të ndryshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në disa raste, GVJ evidentoi mbivendosje kompetencash ndërmjet njësive të ndryshme (p.sh detyrat e NJSBC dhe Departamentit në procesin e monitorimit), [T6-takimi NJSBC]ose mos dokumentim të aktivitetit të përditshëm që lidhet me takimet, diskutimet, raportimet dhe analizat periodike të njësive/strukturave përgjegjëse për organizimin/ofrimin dhe cilësinë e programit të studimit. Për shkak të numrit të vogël të personelit të angazhuar në këto pozicione, u evidentuan raste të ndarjes së detyrave, marrjes së përgjegjëseve respektive për raportime dhe analizës së vazhdueshme të punës dhe përgjegjëseve të çdo njësie/strukture/pozicioni të paqarta.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p><b>Paqëndrueshmëria e personelit (jo vetëm akademik) nga njëra anë krijon dinamizëm në institucion, por nga ana tjetër duhet të krijohet mundësia e transmetimit të memories institucionale dhe e qëndrueshmërisë së strukturave të brendshme të KUR.</b> Edhe në RVB e paraqitur [RVB, fq8], informacioni është i pjesshëm ose mungon.</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ mirëkupton vështirësitë që has institucioni në veprimtarinë e tij për të pasur personel të kualifikuar, dedikuar e përkushtuar në çdo pozicion të strukturës por gjithashtu <b>rekomandon që të gjitha veprimtaritë që kryhen në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit dhe bazën ligjore në fuqi, [rregulloret], (Standardi I.5).</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Një nga praktikatat më të mira të evidentuara nga GVJ është vendosja e marrëdhënieve me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, institucionet shëndetësore në rajonin e Vlorës-Fierit publike e private <b>[lista e marrëveshjeve kombëtare dhe ndërkombëtare]</b>. Veçanërisht marrëveshjet e nënshkruara me spitalet e Vlorës, Fierit, Qendrat shëndetësore, poliklinika etj, ndihmojnë mjaft studentët të zhvillojnë praktikën profesionale dhe stazhin. Edhe në takimin me studentët, oferta dhe mundësitë e dhëna nga ana e institucionit, janë vlerësuar prej tyre.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësisia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Disa prej bashkëpunëtorëve janë punëdhënës të drejtpërdrejtë dhe kanë punësuar disa nga studentët që studiojnë në programin e studimit <b>[T3-takimi me studentët]</b>. Në dokumentin “Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet”, IAL ka paraqitur shpërndarjen e studentëve në qendra të ndryshme spitalore nga viti 2015<b>[raporti analitik i marrëveshjeve]</b>. Megjithatë, <i>GVJ gjykon se ky dokument nuk përmban një raport analitik të marrëveshjeve të bashkëpunimit pasi përmban vetëm informacionin me studentët që kanë zhvilluar praktikatat profesionale. Në të mungojnë informacionet dhe analiza që lidhen me efektin e marrëveshjeve në kuadër, bashkëpunimit të personelit akademik, kërkimit, mobilitetit etj. Për më tepër, informacioni mbi aktivitetin e zhvilluar me disa institucione partnere me të cilat janë nënshkruar marrëveshje, mungon.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

## 2. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Menaxhim Infermieror” është hapur për herë të parë në bazë Urdhrit Nr. 336, datë 13.08.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe është akredituar në vitin 2013 me Urdhërin 327 datë 15.08.2013 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, sipas vendimit Nr. 512 datë 18.07.2013 të Këshillit të Akreditimit. Gjatë këtyre viteve programi i studimit ka pësuar ndryshime të rëndësishme nga 90 ETC në 60 ETC, të miratuar me vendimin e Senatit Akademik Nr.52, datë 03.10.2016 “Për miratimin e ndryshimeve të planit mësimor të MPIM”, bazuar në vendimin e Këshillit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Nr. 2, datë 22.09.2016)[vendimi senatit akademik].
<b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike, FSHM, i referohet nivelit të 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe organizohet në 60 ECTS. Programi është me kohë të plotë dhe realizohet në 1 vit akademik të ndarë në dy semestra, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015[rregullorja e programit].
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<i>Sikundër është konstatuar më lart, program i studimit nuk është riorganizuar në përputhje me VKM 41.GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga KUR, konstaton se nuk është pasqyruar ndryshimi i krediteve për dy lëndë (“Urgjenca mjekësore” në program është 4 ECTS dhe jo 2 ECTS dhe “Menaxhimi i pacientit ne kirurgjinë infantile” është 2 ECTS dhe jo 1 ECTS) në programin mësimor, gjithashtu ndryshimet nuk janë pasqyruar dhe në disa syllabuse.</i>
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Në këtë kuadër, rekomandimi i dhënë në Standardin I.3, vlen edhe në përmbushje të Standardit II.1. <b>GVJ rekomandon rishikimin e programit të studimit dhe pasqyrimin e ndryshimeve të miratuara nga senati (VS Nr.52, datë 30.10.2016) në planin mësimor dhe syllabuset përkatëse (Standardi I.3; Standardi II.1).</b>
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi i studimit MP në “Menaxhim infermieror” përmban një informacion të plotë në fushën e infermieristikës. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuar të infermieristikës si dhe
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke	

<p>grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>përftimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për të shërbyer pacientëve me etikë dhe kujdesje profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Programi i studimit reflekton nevojat që ka tregu dhe ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit <b>[dosja e programit], [plani mësimor i 2019-2020]</b>.</p>
	<p>Me njohuritë e fituara në këtë program studimi, studentët kanë mundësi të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre profesionale në studime të mëtejshme në ciklet pasardhëse. Bazuar në informacionet e marra nga takimi me studentët, pas përfundimit të këtij programi, studentët kanë fituar njohuritë dhe kapacitetet e nevojshme profesionale për të ushtruar profesionin e tyre në institucionet publike dhe jo publike si dhe zgjidhjen e problematikave në praktikën e përditshme në fushën e infermierisë <b>[T3-takimi me studentët]</b>. Programi i studimit MPMI është i organizuar me kohë të plotë në një vit akademik të ndarë në dy semestra në total 60 ETCS (ose 688.5 orë mësimore) nga të cilat praktikës profesionale, punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar i shkojnë 18 kredite<b>[Plani mësimor i programit]</b>.</p>
	<p>Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të dy semestrat janë organizuar në leksione, seminare, praktikë profesionale si dhe orët jashtë auditorit. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm për studentin në masën 75%. <i>Kohëzgjatja e orëve të mësimi është 60 minuta dhe jo 50 minuta</i> <b>[rregullorja e programit]</b>.</p>
	<p>Në semestrin e dytë, studentët ndjekin praktikën profesionale pranë institucioneve/qendrave shëndetësore publike dhe private me të cilat institucioni ka lidhur kontratë/marrëveshje bashkëpunimi <b>[marrëveshjet e bashkëpunimit], [analiza e marrëveshjeve]</b>.</p>
	<p>Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të miratuar nga Këshilli drejtues i fakultetit. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton se orari dhe programi mësimor nuk janë miratuar nga Këshilli drejtues i fakultetit dhe Këshilli i Fakultetit si parashikohet në rregulloren përkatëse dhe dokumenti nuk ka datë, nr. protokollit, vulë apo firmë të organit miratues</i><b>[rregullorja e programit], [Orari mësimor në dy vitet e fundit]</b>.</p>
	<p><i>Gjithashtu, GVJ konstaton se numri i ETCS/orët mësimore në auditor të paraqitura në rregulloren e programit (1015), nuk përputhet me numrin e ETCS/orëve në auditor, në planin e “Plani mësimor në MP në menaxhim infermieror” në dy vitet e fundit ku deklarohen 688.5 orë për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020</i> <b>[plani mësimor]</b>.<i>Në dy dokumentat e dorëzuara pas vizitës në institucion nuk ka përputhje të orëve në auditor për të njëjtin vit akademik.</i></p>

Nga sa më sipër, GVJ rekomandon që në rishikimin e strukturës së programit sipas legjislacionit, të merren parasysh edhe gjetjet dhe konstatimet e mësipërme.

Veprimtaria formuese e këtij programi studimi përbëhet nga 19 lëndë dhe provimi përfundimtar/mbrojtja e mikrotezës e tezës të cilat janë të grupuara në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse dhe me ngarkesën përkatëse në kredite[dosja e programit Master Prof. Menaxhim Infermieror 2018-2019].

Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, Neni 59 pika 8. Gjatë vizitës në institucion GVJ shqyrtoi dokumentin lidhur me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 të miratuar me vendim të senatit. Ngarkesa mësimore përcaktohet në orët mësimore në auditor dhe përfshirja në aktivitete të tjera në dobi të fakultetit[kriteret e shpërndarjes se ngarkesës se stafit], [vendim i rektorit KUR].

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga KUR për këtë program studimi, GVJ konstatoi se ka:**

- mospërputhje në ndarjen e kategorive formuese në lëndë A,B, C,D dhe E sipas VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Lënda e gjuhës së huaj është grupuar në kategorinë A dhe jo D dhe praktika profesionale në E në vend të D;
- mospërputhje të ngarkesës së krediteve (në%) sipas kategorive të përcaktuara në këtë VKM. Ngarkesa në kredite sipas kategorive përkatëse është: Kategoria A 13.3%; Kategoria B 53.3 %; Kategoria C 3.3%;Kategoria E 16.6%;Kategoria F 13.3%**[Plani mësimor i programit të studimit “MP” në “Menaxhim infermieror” në dy vitet e fundit].Në programin e KUR mungon kategoria D;**
- nuk është pasqyruar ndryshimi i ngarkesës në ECTS në vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020 në lëndën “Menaxhim i pacientit në kirurgjinë infantile” nga 2 ECTS në 1 dhe “Menaxhim i pacientit në urgjencat mjekësore” nga 4ECTS në 2. Gjithashtu, ndryshimi i ECTS nuk është pasqyruar dhe në disa syllabuse të lëndëve;
- mospërputhje të numrit të syllabuseve të dorëzuar me lëndët e programit(Për vitin 2015-2016 ka më shumë syllabuse se lëndët në program. Për vitin akademik 2018-19 ka më pak syllabuse se programi)[dosja e programit, plani mësimor];
- mospërputhje të numrit të ECTS të këtij programi studimi me numrin e ECTS/orëve mësimore të deklaruara në

syllabuset e planit mësimor [**dosja e programit, plani mësimor**];

- *formati/struktura e syllabuseve nuk është sipas VKM 41;*
- *Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, titullari i lëndës duhet të jetë i kategorisë Profesor. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni në të gjitha lëndët e zhvilluara në këtë program mungon titullari i lëndës. Syllabuset janë miratuar vetëm nga drejtuesi i njësisë bazë (drejtuesi i departamentit);*
- *literatura në syllabus nuk përputhet me tematikën e lëndës (mjekësi transfuzive);*
- *nuk respektohet raporti ECTS/orë mësimore sipas udhëzimit të MASR. Në konvertimin e krediteve ECTS në orë mësimore janë përdorur raporte të ndryshme në lëndë të ndryshme [**plani mësimor në dy vitet e fundit**];*
- *numri i madh i lëndëve të programit (19 lëndë) në raport me kohëzgjatjen e studimit, 1 vit akademik).*

**Nga sa më sipër, programi nuk është strukturuar sipas legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi. Për këtë arsye, në përmbushje të gjetjeve të mësipërme, programi i studimit të riorganizohet brenda vitit akademik 2019-2020 (Standardi I.3, Standardi II.1).**

Pjesë e programit të studimit MP në “Menaxhim infermieror” është dhe praktika profesionale, e cila është 10 ECTS/240 orë mësimore dhe kryhet sipas programit kalendarik të miratuar nga senati i KUR. Praktikant profesionale të studentëve kryhen në institucionet shëndetësore publike ose jo publike më të cilat KUR ka nënshkruar kontrata/marrëveshje bashkëpunimi. Praktika profesionale mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika dhe vlerësohet nga pedagogu mbikëqyrës [**plani mësimor 15—16, neni 29-30 i rregullores së fakultetit**]. Referuar RVB dhe takimit me stafin akademik, një pedagog ndjek 3 studentë. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizmin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën [**manuali-regjistri i praktikës së studenteve**].

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		<b>X</b>		

**Standardi II.2**

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Struktura organizative e programit përbëhet nga organet drejtuese, autoriteti drejtues, komisionet, stafi akademik dhe administrata <b>[rregullorja e programit]</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Në Departamentin e Shkencave Mjekësore Teknike: <ul style="list-style-type: none"> <li>- për vitin <b>2018-2019</b> janë angazhuar 10 (dhjetë) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 7 (shtatë) pedagogë si personel akademik me kontratë.</li> <li>- për vitin akademik <b>2017-2018</b> janë angazhuar 9 (nëntë) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 5 (pesë) pedagogë si personel akademik me kontratë.</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	<ul style="list-style-type: none"> <li>- për vitin akademik <b>2016-2017</b> janë angazhuar 7 (shtatë) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 5 (pesë) pedagogë si personel akademik me kontratë.</li> <li>- për vitin akademik <b>2015-2016</b> janë angazhuar 7 (shtatë) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 7 (shtatë) pedagogë si personel akademik me kontratë.</li> <li>- për vitin akademik <b>2014-2015</b> janë angazhuar 7 (shtatë) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 3 (tre) pedagogë si personel akademik me kontratë.</li> </ul>
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Për sa më lart, personeli akademik efektiv në këto vite akademike, <b>në departament, në aspektin numerik</b> , përbën: 70 % të stafit akademik për vitin akademik 2014-2015; 50 % të stafit akademik për vitin akademik 2015-2016; 58.3 % të stafit akademik për vitin akademik 2016-2017; 58.8 % të stafit akademik për vitin 2017-2018 dhe 64.2% për vitin akademik 2018-2019.
<b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Për vitin akademik <b>2018-2019</b> , në Departamentin e Shkencave Teknike, janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof., 1 Prof. As., 1 Dr., 6 Msc dhe 1MP dhe si pedagogë me kontratë: 1 Prof. As, 3 Dr. dhe 3 Msc.
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Për vitin akademik <b>2017-2018</b> janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof., 1 Prof. As, 1 Dr., 5 Msc. dhe 1 MP. dhe si pedagogë me kontratë: 1 Prof. As, 3 Dr. dhe 1Msc. Për vitin akademik <b>2016-2017</b> janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof., 1 Prof. As, 1 Dr., 3 Msc. dhe 1 MP. dhe si pedagogë me kontratë: 1 Prof. As, 3 Dr. dhe 1Msc.
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë	Për vitin akademik <b>2015-2016</b> janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof., 1 Prof. As, 1 Dr., 3 Msc. dhe 1 MP. dhe si pedagogë me kontratë: 1 Prof. As, 4 Dr. dhe 2 Msc.



periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.

Për vitin akademik **2014-2015** janë angazhuar si pedagogëefektivë: 1 Prof., 1 Prof. As, 1 Dr., 3 Msc. dhe 1 MP. dhe si pedagogë me kontratë: 1 Prof. As dhe 2 Dr.

*Në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar nuk jepen të dhëna për personelin akademik ndihmës.*

*Nga viti 2013, numri i stafit akademik në departament është rritur në numër, duke angazhuar staf akademik me MSc.*

*GVJ pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion konstatoi se në departament në procesin e mësimdhënies është përfshirë dhe një staf akademik me kohë të plotë me Master Profesional **[RVB, lista e stafit akademik]**.*

*Në aktet ligjore në fuqi është përcaktuar se në procesin e mësimdhënies duhet të përfshihet personel akademik me tituj dhe grada shkencore.*

Për realizimin e programit, janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc/MP. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe departament, por për shkak të mospërputhjes së të dhënave lidhur me PAE/PAK në listën e stafit akademik me atë të shpërndarjes së ngarkesës mësimore, GVJ nuk mund të llogarisë ngarkesën në orë dhe % që mbulohet nga PAE dhe PAK.

Nga verifikimet për stafin e institucionit që ushtrojnë funksione drejtuese konstatojmë se:

**Drejtuesi i njësisë kryesore dhe njësisë bazë të shkencave mjekësore teknike janë mbi limitin e moshës së lejuar për punësimin me afat të pacaktuar. Kjo bie ndesh me përcaktimet e nenit 65 të Ligjit të arsimit të lartë, dhe të nenit 46 të Statutit të Institucionit për kohëzgjatjen e mandatit të ushtrimit të funksionit të tyre.**

Referuar RVB, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm nuk ka paraqitur informacionin e nevojshëm në raport por konstatimet e mësipërme janë nxjerrë nga analiza e informacionit të vënë në dispozicion gjatë vizitës në institucion **[RVB fq10 -11]**.

Nga të dhënat e mësipërme dhe nga analiza e CV të personelit akademik **[Cv stafi]**, rezulton se pavarësisht përpjekjeve të bëra nga institucioni, rolin kryesor në mbulimin e programit të studimit e luan personeli me kontratë i cili ka përgatitjen e duhur profesionale **[T5-takimi me stafin]**, çka tregon se njësia përgjegjëse për programin e studimit **përmbush pjesërisht detyrimet ligjore dhe nënligjore** që lidhen me angazhimin në

	<p>institucion, moshën dhe aktivitetin akademik në funksion të programit dhe institucionit në tërësi [RVB fq36].</p> <p><b>GVJ rekomandon që institucioni të vazhdojë përpjekjet për të rritur cilësinë e personelit me kohë të plotë në përbushje të detyrimeve ligjore dhe në përbushje të standardeve të cilësisë (Standardi II.2).</b></p> <p>Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe konstatoi se ky staf i përbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.</p> <p>Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit mësimor-shkencor me kohë të plotë, për mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditorit dhe mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor.</p> <p>Programi ka një koordinator të emëruar me vendim Nr. 2, datë 13.11.2018 të Rektorit të KUR, i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion.</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale. Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuara në rregulloren e funksionimit të programit [rregullorja e programit].</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbytjen e programeve të studimeve.	GVJ pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të dorëzuar, dokumentacionit gjatë vizitës në institucion dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion [dosja e programit] konstaton se departamenti zotëron, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbytjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar në lëndë, praktikë profesionale dhe aktivitete formuese. <i>Sikundër është theksuar më lart, nuk është ruajtur raporti në % i shpërndarjes së veprimtarive formuese në kategori të veçanta sipas përqindjes së përcaktuar në VKM 41.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module,	

<p>të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga KUR dhe vizitës në institucion, konstatoi se programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në një vit akademik të ndara në 2 semestra.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në njësinë bazë ku zhvillohet programi i ciklit të dytë të studimit MP në “Menaxhim infermieror” gjendet informacioni i nevojshëm lidhur me programin, ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe frekuentimin e programit, orarin e zhvillimit të programit, etj. GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka një informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit [rregullorja e KUR, rregullorja e FSHM], por nga takimi me studentët rezultoi që nuk janë aplikuar kritere specifike përzgjedhëse përveç mesatares në pranime të vendosur me VKM.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i SHMT ku realizohet ky program studimi, përmbajnë informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon programi, ndarjen në leksione, seminare, orët brenda dhe jashtë auditorit si dhe syllabus dhe udhëzues për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj [manual-regjistër i praktikës].</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve në përgjithësi përmbajnë informacionin e nevojshëm, por ato duhet të riorganizohen në përputhje me VKM 41.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi i studimit, pas akreditimit të parë, ka pësuar ndryshime të cilat janë të miratuara me Vendim Senati [vendim senati]. GVJ konstaton se institucioni nuk zbaton një procedurë të qartë të përmirësimeve/ndryshimeve të programeve të studimit. Për më tepër, edhe ndryshimet e vëna në dispozicion nuk paraqesin procedurën e kryer, argumentimet se përse këto ndryshime janë të nevojshme, diskutime në njësinë përgjegjëse të programit të studimit, aprovimin dhe dokumentimin e të gjithë dokumentacionit.</p> <p>Referuar këtij konstatimi, GVJ rekomandon që institucioni të zbatojë aktet e brendshme rregullatore për hartimin dhe miratimin e programeve të reja dhe riorganizimin /përditësimin e programeve ekzistuese si dhe të dokumentojë dhe arkivojë çdo veprimtari të zhvilluar gjatë këtyre proceseve (Standardi II.3).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktikë profesionale me ngarkesën përkatëse në kredite <b>[plani mësimor 2018-2019]</b> bazuar në legjislacionin në fuqi. <i>Ndarja në kategori (A në F) dhe ngarkesa në krediteve (në%) për veprimtaritë formuese nuk përputhet me legjislacionin në fuqi VKM 41 dhe duhet të ndryshojë <b>[dosja e programit]</b>.</i> <i>Shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga vetë institucioni, por GVJ nuk identifikoi metodologjinë e ndjekur në zbatim të Udhëzimit të MASR për ngarkesën mësimore në institucionet e arsimit të lartë.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	<i>Shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga vetë institucioni, por GVJ nuk identifikoi metodologjinë e ndjekur në zbatim të Udhëzimit të MASR për ngarkesën mësimore në institucionet e arsimit të lartë.</i> <i>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe departament, por për shkak të mospërputhjes së të dhënave lidhur me PAE/PAK në listën e stafit akademik me atë të shpërndarjes së ngarkesës mësimore, GVJ nuk mund të llogarisë ngarkesën në orë dhe % që mbulohet nga PAE dhe PAK.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të infermieristikës të përshtatura me kërkesat e tregut të punës në veçanti në rrethin e Vlorës dhe Fierit <b>[dosja e programit], [rregullorja e programit]</b> .
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre <b>[T3-takimi me studentë]</b> .
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orëmësimore përputhet me profilin MP në "Menaxhim infermieror". Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe kombëtare, ndryshime janë vetëm në numrin e ECTS për lëndë <b>[Referuar RVB, takimit me stafin drejtues të KUR dhe stafin akademik]</b> por e pa mbështetur në dokumente konkrete.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	

<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Mosndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre, ndikon në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Bazuar në deklaratimet e drejtuesve [T1-takimi me drejtuesit], studentët që kanë përfunduar këtë program studimi janë punësuar dhe një pjesë e tyre kanë funksione drejtuese në institucione shëndetësore publike të rrethit të Vlorës [punësimi i studentëve].</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Institucioni, u ka ofruar studentëve mundësi për trajnime apo kryerjen e praktikave profesionale si dhe një program doktorature në institucione jashtë vendit në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka me institucione në Itali, por për shkak të rrethanave familjare, studentët apo pedagogët nuk kanë patur mundësi për ti realizuar [T3-takimi student], [T5-takimi me stafin].</p> <p>Përmbajtja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive të përftuara në ciklin e parë të studimit dhe profilizimin e tyre në një fushë më të ngushtë, në atë të menaxhimit infermieror, duke bërë të mundur përfitimin e aftësive, shprehive për të përfituar aftësitë e duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre.</p> <p>Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron studentëve informacionin e duhur për thellimin e njohurive në menaxhimin infermieror [rregullorja programit], [plani mësimor], [orari mësimor].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Asnjë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi II.5</b></p>	
<p><b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik (kryesisht ai me kontratë) që mbulon programin Master Profesional në “Menaxhim infermieror” përbëhet nga pedagogë me eksperiencë dhe kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga IAL, ka mospërputhje ndërmjet të dhënave të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi të paraqitura në: listën e</i></p>

<p>pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p><i>stafit akademik, planin mësimor të lidhur me stafin akademik, syllabuset e programit të studimit (referuar planit mësimor, orarit të mësimëve, CV të personelit). Për të dhënat në vijim, GVJ, i është referuar dokumentit “Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit” të dorëzuar nga IAL.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Sipas këtij dokumenti, në këtë program studimi janë angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në vitet akademike <b>2018-2019</b> dhe <b>2019-2020</b>: 4 pedagogë efektivë dhe 6 pedagogë me kontratë. <b>Në aspektin numerik</b>, raporti për këto vite akademike është 40 % PAE / 60 % PAK.</li> <li>- Në vitin akademik <b>2017-2018</b>: 4 pedagogë efektivë dhe 7 pedagogë me kontratë. <b>Në aspektin numerik</b>, raporti është 36.4 % PAE / 63.6 % PAK.</li> <li>- Në vitin akademik <b>2016-2017</b>: 5 pedagogë efektivë dhe 7 pedagogë me kontratë (<i>Sipas IAL janë paraqitur 8 pedagogë me kontratë por emri i njërit prej pedagogëve është përsëritur dy herë</i>). <b>Në aspektin numerik</b>, raporti është 41.7 % PAE / 58.3 % PAK.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në vitin akademik <b>2015-2016</b>: 7 pedagogë efektivë dhe 9 pedagogë me kontratë (<i>Sipas IAL janë paraqitur 10 pedagogë me kontratë por emri i njërit prej pedagogëve është përsëritur dy herë</i>). <b>Në aspektin numerik</b>, raporti është 43.75 % PAE / 56.25 % PAK.</li> </ul> <p>Në vitet akademike <b>2018-2019</b> dhe <b>2019-2020</b>, <b>stafi akademik efektiv</b> i angazhuar në këtë program studimi paraqitet me kualifikimin <b>1 Prof. As</b> dhe <b>3 Msc.</b>, ndërsa <b>stafi akademik me kontratë</b> paraqitet me kualifikimin <b>1 Prof. As., 2 Dr.</b> dhe <b>3 Msc.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p><i>Për vitet e tjera të mëparshme akademike nuk mund të paraqitet kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit pasi të dhënat e paraqitura nga IAL nuk janë të plota dhe ka mospërputhje.</i></p> <p>Sikurse përmendur edhe më lart, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me stafin akademik në vite, GVJ konstatoi se ka mospërputhje të listës emërore të stafit akademik të angazhuar në këtë program me pedagogët që zhvillojnë programin mësimor [<b>orari mësimor</b>] si dhe pozicionit të tyre PAE apo PAK [<b>personeli akademik</b>].</p> <p><b>Referuar këtyre mospërputhjeve, GVJ nuk mund të llogarisë ngarkesën në orë dhe % që mbulohe nga PAE dhe PAK.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në program dhe departament, por ka</li> </ul>

mospërputhje të të dhënave lidhur me PAE/PAK në listën e stafit akademik dhe atë të shpërndarjes së ngarkesës mësimore. **Megjithatë, pjesa më e madhe e orëve mësimore të programit tëstudimit zhvillohet nga PAK.**

- Ngarkesa mësimore e studentëve gjatë një jave varion përtej 20-25 orë mësimore në javë (VKM 41). Në semestrin e parë studenti zhvillon rreth 13 orë në javë, në semestrin e dytë më shumë se 25 orë në javë [orari mësimor].

*Në vite vihen re lëvizje të shumta të stafit akademik dhe veçanërisht rënie të numrit të stafit akademik në këtë program studimi, nga 16 pedagogë në vitin akademik 2015-2016 në 10 pedagogë në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020. Në vite konstatohet rënie e numrit të PAE dhe rritje e stafit akademik me kontratë.*

Kjo problematikë është evidentuar edhe vetë nga ana e institucionit dhe është reflektuar edhe në RVB [RVB analiza SWOT].

**Në këtë kuadër, mbetet detyrë e institucionit që jo vetëm tërekrutojë personel me kualifikim, fushë akademike-kërkimore në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të programit por të motivojë dhe promovojë ata në mënyrë që të garantojë cilësi dhe qëndrueshmëri afatgjatë të tyre në institucion (Standardi II.5).**

Referuar listës së stafit akademik të angazhuar në këtë program [të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit]për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit MP në “Menaxhim infermieror” janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc/MP.Në programin e studimit është përfshirë PAE me Msc/MP, që nuk përputhet me legjislacionin në fuqi.

*Në programin e studimit janë angazhuar pedagogë me kualifikim MSc dhe drejtim fizioterapi, që nuk përputhet me programin e studimit[tëdhëna tabelore për personelin akademik ne programin e studimit], [Cv e stafit].*

Ngarkesa e stafit akademik bazohet në udhëzimin 29 të Ministrisë së Arsimit dhe vendimit të Senatit akademik por ka raste kur ngarkesa maksimale që mbulojnë pedagogët në këtë program në orë mësimore është më e lartë se ajo e miratuar nga vetë institucioni.

Në RVB dhe dokumentacionin e dorëzuar nuk është paraqitur staf akademik ndihmës. Në RVB ka paqartësi lidhur me stafin akademik PAE/PAK dhe atëndihmës[RVB],[stafi akademik i departamentitdhe programit 2015-2018].

	<p>Institucioni, për realizimin e praktikës profesionale dhe temave të diplomave të studentëve apo kryerjen e doktoratave dhe veprimtarive të tjera kërkimore shkencore, ka nënshkruar një sërë kontratash me institucione arsimore dhe shëndetësore publike dhe private <b>[marrëveshjet me institucione vendase dhe të huaj]</b>.</p> <p><i>GVJ konstatoi se në marrëveshjet e nënshkruara me institucione jashtë vendit, KUR prezantohet si Universitet dhe jo Kolegj, sikundër statusi i këtij institucioni.</i></p> <p>Lista e institucioneve partnere të vëna në dispozicion për personelin dhe studentët konsiderohet mjaft pozitive nga GVJ. Ajo ndihmon të realizohen praktikat profesionale, punimin e diplomave dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p> <p>Nga informacionet e vëna në dispozicion, nuk ka të dhëna mbi angazhimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, por referuar infrastrukturës dhe gjendjes së tyre, rezultojnë që institucioni kujdeset për infrastrukturën laboratorike dhe e mban atë në funksion të procesit mësimor <b>[T7-vizita e ambienteve]</b>.</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Në përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X		

<b>Standardi II.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Sikundër u theksua më lart, institucioni kryhen rishikim të programeve të studimit të cilat kanë si qëllim përshtatjen të tyre me kërkesat e tregut të punës <b>[T1-takimi me drejtuesit]</b>.</p> <p>Gjatë takimit që pati me studentët, GVJ, konstatoi se studentët përfshihen në rishikimin e programit mësimor dhe sugjerimet e tyre janë marrë parasysh sidomos në drejtim të shtimit të orëve të praktikës <b>[T3-takimi me studentët]</b>, por jo të ngarkesës në lëndë mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ kontaktoi studentë të cilët kishin kryer këtë cikël studimi, të cilët u shprehën se dijet e fituara në program ju kanë shërbyer në punën e tyre të përditshme dhe rritjen e tyre profesionale <b>[T1-takimi me studentët]</b>.</p> <p><b>GVJ sugjeron që rishikimi i programit të kryhet duke ju referuar dhe kërkesave të tregut të punës në rrethin e Vlorës dhe qyteteve përreth.</b></p>



funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Në takimin me drejtuesit e KUR dhe stafin akademik u deklarua se nevojat për infermierënvendjanë në rritje për shkak të largimit të tyre në emigracion. Bazuar në këto të dhëna si dhe kërkesat dhe nevojat për infermierë në institucionet shëndetësore është marrë vendimi për hapjen e këtij programi studimi.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Në takimet e zhvilluara, drejtuesit dhe personeli akademik theksuan se bashkëpunojnë me institucione të ndryshme në kuadër të përmirësimit, përshtatjes dhe riorganizimit të programeve në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike lokale të zhvillimit [T1-takimi me drejtuesit].GVJ nuk evidentoi dokumente dhe informacione që dëshmojnë këtë angazhim të partnerëve, bashkëpunëtorëve dhe studentëve të diplomuar.			
<b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.				
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
		X		

### 3. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	KUR ka hartuar disa rregullore për funksionimin e institucionit, të miratuara nga Senati Akademik me vendim Nr.10, datë 10.08.2017 [rregulloret e KUR].Rregullorja e programit të studimit përcakton elementët e mësimdhënies në programin e studimit, procesin e vlerësimit dhe testimit të njohurive. GVJ nuk evidentoi mekanizma të mësimdhënies të bazuara në metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me ato online[takimet me stafin dhe studentët].
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të	Për monitorimin e mësimdhënies dhe cilësisë së saj, institucioni ka në funksionim NJSBC e cila monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike procesin mësimor, aftësitë e stafit akademik

personelit akademik dhe ndihmësakademik.	bazuar në pyetësorin e studentëve, ndjekjen e orëve mësimore në auditor, aktivitetin e tyre shkencor si dhe kontributin e tyre në funksion të institucionit [rregullore e fakultetit], [rregullore NJSBC], [raporti i NJSBC].			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni, në mënyrë periodike çdo vit, vlerëson metodat e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit nga studentët. Studentët shprehin vlerësimet e tyre për procesin e mësimdhënies, vlerësimin e tyre nga stafi akademik si dhe problematikat e ndryshme të hasura gjatë vitit akademik.			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit, pasi mblihen dhe përpunohen, publikohen nga struktura përkatëse dhe bëhen të aksesueshme për studentët dhe stafin e KUR.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Rezultatet e vlerësimit dhe monitorimit të mësimdhënies bëhen publike në faqen e internetit duke promovuar pedagogët me rezultatet më të mira dhe inkurajon stafin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies [raporti vjetor 2017 - 2018]. <i>GVJ identifikoi se njësi përgjegjëse për programin e studimit (Departamenti i Shkencave Teknike Mjekësore) zbaton pjesërisht përcaktimet e Nenit 45 të Statutit "Funksionet dhe kompetencat e Përgjegjës të Departamentit", nenin 8 të Rregullores së përgjithshme, në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë së mësimdhënies. Në dokumentacionin e dorëzuar, Përgjegjësi i Departamentit është Dr. S.F. ndërsa në takimin me stafin drejtues u paraqit Dr. V.H. (e cila është personel akademik me kontratë). GVJ konstatoi dokumentim të pjesshëm të aktivitetit në nivel departamenti dhe rekomandon që njësi bazë të marrë rolin kryesor sipas përcaktimit që ka në organizimin, zhvillimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të programit të studimit. GVJ rekomandon që njësitë akademike dhe administrative për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies të hartojnë udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit, të kryejnë dhe dokumentojnë në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin e tyre (Standardi III.1).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

#### Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e

KUR përdor në procesin mësimor metodat standarde në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, praktika

<p>njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>profesionale, tema diplome si dhe leksione të hapura me lektorë shqiptarë dhe të huaj <b>[rregullore e programit]</b>. Personeli akademik përdor metoda alternative gjatë mësimdhënies si prezantime në powerpoint, biseda interaktive, apo zhvillojnë dhe orë jashtë orarit me kërkesë të studentëve. Stafit akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të praktikës mësimore.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Personeli akademik merr parasysh kërkesat dhe sugjerimet e studentit për zhvillimin më efektiv dhe cilësor të mësimit, leksione apo seminare, për ti bërë ato më efektive dhe tërheqëse për studentët <b>[T3-takimi me studentët], [T5-takimi me stafin]</b>. Institucioni i siguron stafit akademik logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor duke bërë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyre periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vlerësimit <b>[pyetësori me studentët]</b>. Mendimet dhe propozimet e studentëve rezultojnë se merren parasysh gjatë diskutimeve midis personelit akademik dhe studentëve <b>[T3-takimi me studentët]</b>. Me propozim të studentëve është përmirësuar infrastruktura e mësimdhënies dhe janë ngritur laboratorë në funksion të procesit mësimor si dhe janë siguruar mulazhet e nevojshme për të fituar shprehinë e punës si kryerja e manipulimeve të ndryshme mjekësore që kryhen tek pacienti. Personeli akademik përdor projektorët për prezantime powerpoint për dhënien e leksioneve dhe prezantimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Gjatë procesit mësimor dhe praktikës profesionale apo punimit të temës së diplomës, studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në ndërtimin e strukturës së diplomës, zgjedhjen e temës apo hartimin e saj duke gjetur tema të lidhura me problematika kryesore të shërbimit shëndetësor. p.sh. infeksionet spitalore mbeten problem për sistemin shëndetësor, kështu këtë vit, një nga temat e diplomës së studentëve ka qenë infeksionet spitalore në spitalin e qytetit të Vlorës <b>[T5-takimi me stafin], [T3-takimi me studentët]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p><i>GVJ nuk identifikoi forma dhe metoda të tjera të përdorimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve që ndërthuren me teknologjinë.</i></p>

<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Në këtë drejtim, <b>institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme, inovative dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese që ka programi i studimit (Standardi III.2).</b>			
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësuesit dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Institucioni ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor të cilat janë të mjaftueshme, të pastra dhe të mirëmbajtura, të pajisura me sistem kondicionimi dhe ndriçimin e duhur <b>[T7-vizita e ambienteve]</b> . Ambientet ku zhvillohet procesi mësimor kanë logjistikë nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me kompjuter dhe projektorë për zhvillimin e mësimit, tabela shkrimi të cilat ndikojnë në rritjen e cilësisë së mësimit <b>[të dhënat për infrastrukturë]</b> , <b>[T7-vizita e ambienteve]</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikë e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve burime të ndryshme informacioni si internet, literaturë të shkruar, kompjutera, salla pune dhe leximi <b>[të dhënat për infrastrukturën]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Studentët i marrin leksionet në formë elektronike ose të printuara, kanë libra në gjuhën shqipe apo të huaj. Në fund të çdo syllabusi studentit gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor <b>[format syllabusi]</b> , <b>[syllabuset e lëndëve]</b> .
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të	Institucioni ka në funksion të studentëve dhe personelit akademik bibliotekën e cila ka materiale në shqip dhe në gjuhë të huaj. Institucioni publikon listën e librave të rinj që hyjnë në bibliotekë, oraret e shfrytëzimit të ambienteve të bibliotekës nga

nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	studentët apo stafi akademik [T7- vizita e ambienteve].GVJ konstatoi se në bibliotekën nuk ka një punonjës bibliotekë.			
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Institucioni i siguron studentëve dhe pedagogëve mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që ata frekuentojnë. Institucioni siguron laboratorë të mjaftueshëm në funksion të programit mësimor si laborator i informatikës, fizikës, laborator i anatomi histologji, kabineti fizioterapisë, farmacisë, stomatologjisë, etj., të pajisur me pajisje të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe praktikave laboratorike që i mundëson studentëve të fitojnë shprehitë e punës në laborator apo të familjarizohen me procedura të ndryshme në fushën mjekësore [të dhëna për infrastrukturën]. Në lidhje me infrastrukturën online, institucioni ka faqen zyrtare të institucionit në të cilën publikohen informacione dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, duke iu referuar rregullores të sistemit të menaxhimit të informacionit [rregullore e sistemit të menaxhimit të informacionit], në këtë rregullore nuk ka informacione lidhje me komponentët informatikë të këtij sistemi. Nga takimet me stafin, studentët, sekretarinë dhe burimet njerëzore, rezultoi se institucioni nuk ka në përdorim ndonjë sistem menaxhimi të informacionit, sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore apo platformë në funksion të mësimdhënies online dhe në distancë sipas përcaktimeve të Standardit III.3. Nga sa më sipër, GVJ i rekomandon institucionit të zhvillojë infrastrukturën e nevojshme në funksion të menaxhimit të institucionit dhe në funksion të mësimdhënies (Standardi III.3). Temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me pedagogët e tyre në mënyrë që temat e tyre të jenë lidhur me problematikat aktuale të sistemit shëndetësor, të jenë në funksion të përgatitjes së tyre profesionale dhe mundësive aktuale për realizimin e pjesës eksperimentale të tyre. Institucioni ka një rregullore për procedurën e zgjedhjes dhe miratimit të temës së diplomës dhe vlerësimin e saj [udhëzues për punimin e temës së diplomës].			
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë librarinë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.				
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.				
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.				
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.				
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Njësia përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional është NJSBC[rregullore NJSBC]. Kjo njësi harton plan pune që miratohet nga Rektori i KUR dhe e ndjek atë në vitin pasardhës [plan pune NJSBC]. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies shërbejnë dhe leksionet e hapura të organizuara nga departamentet në ditë të veçanta kombëtare të lidhura me shëndetin si dita e diabetit, hipertensionit, dhurimit të gjakut, talasemisë, etj. Në këtë ditë krahas pedagogëve paraqiten dhe punë të kryera nga studentët apo referime të përgatitura prej tyre. Të gjitha këto ndikojnë në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe përfshirjen aktive të studentëve në këto aktivitete. <i>Institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve [T7-vizita e ambienteve], [T5-takime me stafin], [T3- takime me studentë] ( Standardi III.4).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike është njësi përgjegjëse për realizimin e procesit mësimor dhe përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies, rritjen e cilësisë së tyre dhe përmirësimin e programeve mësimore. Pavarësisht përpjekjeve që kanë bërë drejtuesit e institucionit, fakultetit dhe departamentit, bazuar në diskutimet e kryera me ta [T1-takimi me drejtuesit],rezulton se ka ende punë për të rritur vetë ndërgjegjësimin tepersoneli akademik në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në rregulloret e funksionimit të FSHM dhe Rregulloren e programit [rregullorja programit], [rregulloret e fakultetit],janë paraqitur dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e personelit akademik.
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor dhe praktikave laboratorike. <i>Referuar impaktit të aktivitetit kërkimor që ka realizuar personeli akademik, si infrastruktura laboratorike për studime të avancuara, kërkime shkencore, etj., po ashtu dhe angazhimi i personelit nuk është në nivelin e duhur[aktiviteti kërkimor shkencor].</i>
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, konferenca apo rimbursimtëshpenzimeve të udhëtimit, realizimit të konferencave të përbashkëta me IAL brenda vendit apo jashtë, mbështetje bursë për realizim të temave të doktoraturës në
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>kuadër të projekteve të bashkëpunimit që kanë me institucione jashtë vendit (Itali), realizimin e botimeve në buletin shkencor të fakultetit apo revista të tjera, brenda dhe jashtë vendit [T5-takimi me stafin drejtues], [aktiviteti kërkimor shkencor], [revista shkencore e KUR].</p> <p>Institucioni i ka siguruar infrastrukturën fizike të nevojshme departamenteve për trajnim të stafit akademik për zbatimin e metodave inovative në mësimdhënie në bashkëpunim me strukturat drejtuese dhe departamentet e tjera të FSHM. <i>Paqendrueshmëria e personelit akademik dhe mos angazhimi i tyre, nuk ka çuar në efekte të dukshme në rritjen e përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</i></p> <p>Për këtë arsye, <b>GVJ rekomandon që institucioni të sigurojë dhe promovojë përdorimin e teknologjisë dhe metodave inovative të mësimdhënies duke motivuar personelin akademik dhe studentët (Standardi III.4).</b></p> <p><i>Për më tepër, institucioni nuk disponon ende infrastrukturën logjistike të bazuar në teknologji për aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies [T7-vizita e ambienteve].</i></p> <p>Institucioni realizon takime apo konferenca të veçanta që shërbejnë për shkëmbim eksperience dhe shpërndarje të informacionit duke ftuar profesorë të huaj kryesisht nga Italia për tema të caktuara, seminare, konferenca, etj. Këto aktivitete i shërbejnë përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. <i>Institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve [takim me studentët dhe pedagogët gjatë vizitës në institucion] (Standardi III.4).</i></p> <p><i>GVJ vëren që aktivitetet në fushën e infermieristikës janë të pakta. Edhe analiza e paraqitur nga ana e GVB në raportin e vlerësimit të brendshëm është e pjesshme, pa informacione të detajuara për të mbështetur kriteret e standardit.</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Institucioni i ka siguruar infrastrukturën fizike të nevojshme departamenteve për trajnim të stafit akademik për zbatimin e metodave inovative në mësimdhënie në bashkëpunim me strukturat drejtuese dhe departamentet e tjera të FSHM. <i>Paqendrueshmëria e personelit akademik dhe mos angazhimi i tyre, nuk ka çuar në efekte të dukshme në rritjen e përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</i></p> <p>Për këtë arsye, <b>GVJ rekomandon që institucioni të sigurojë dhe promovojë përdorimin e teknologjisë dhe metodave inovative të mësimdhënies duke motivuar personelin akademik dhe studentët (Standardi III.4).</b></p> <p><i>Për më tepër, institucioni nuk disponon ende infrastrukturën logjistike të bazuar në teknologji për aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies [T7-vizita e ambienteve].</i></p> <p>Institucioni realizon takime apo konferenca të veçanta që shërbejnë për shkëmbim eksperience dhe shpërndarje të informacionit duke ftuar profesorë të huaj kryesisht nga Italia për tema të caktuara, seminare, konferenca, etj. Këto aktivitete i shërbejnë përmirësimit të metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. <i>Institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve [takim me studentët dhe pedagogët gjatë vizitës në institucion] (Standardi III.4).</i></p> <p><i>GVJ vëren që aktivitetet në fushën e infermieristikës janë të pakta. Edhe analiza e paraqitur nga ana e GVB në raportin e vlerësimit të brendshëm është e pjesshme, pa informacione të detajuara për të mbështetur kriteret e standardit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

<p><b>Standardi III.5</b>  <b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të</p>	<p>Institucioni zotëron rregullore për organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët [rregullore e fakultetit], [rregullore e zhvillimit të provimeve].</p>

posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FSHM si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve[<b>plani mësimor</b>], [<b>dosja e programit</b>].</p> <p>Testimi i dijeve dhe aftësive profesionale bëhet mbi bazë pikëzimi, me shkrim, gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit. Mënyra e vlerësimit ju komunikohet studentëve në fillim të procesit mësimor.</p>			
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.				
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	<p>Testimi i dijeve të studentëve bëhet në fund të programit mësimor. Procedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores “<i>Për zhvillimin e provimeve të miratuar nga senati</i>”[<b>rregullore e provimeve</b>].</p> <p>Nuk përdoren sisteme elektronike të testimit në këtë program studimi.</p> <p>Provimi zhvillohet nga dy pedagogë, njëri prej të cilëve është pedagogu i lëndës.</p> <p><i>Por, gjatë vizitës në institucion, GVJ identifikoi raste ku fletët e provimit ishin vetëm me firmën e një pedagogu</i>[<b>T4-takimi me sekretarinë mësimore</b>].</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminonjë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	<p>Testimi i dijeve kryhet me shkrim dhe në mënyrë anonime me sekretim. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit. Në pjesën e pasme të fletës së provimit janë të shënuara kriteret e vlerësimit.</p> <p>Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Komisioni i</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>vlerësimit mbledh kërkesat e studentëve dhe pas rishikimit të fletës së provimit cakton një datë për të biseduar me studentët.</p> <p>Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve [T3-takimi me studentët].</p> <p>Për çdo provim, pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës sipas procedurës së miratuar në rregulloren përkatëse të provimit.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Kërkesat për rishikim mblidhen dhe shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>				
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>				
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit të ciklit të dytë MP në “Menaxhim infermieror” është 1 vit akademik, 2 semestra dhe ka 60 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore = 50 minuta.
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. <i>Nga studentët u deklarua se ngarkesa në program është e madhe sepse janë një numër i madh lëndësh në raport me kohëzgjatjen e programit.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë të studimeve, studentët pajisen me diplomë Master profesional, me emërtimin MP në “Menaxhim infermieror”. Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit, diploma mbrohet me punimin e një mikroteze/diplome. Diploma i jepet studentit që ka kryer të gjitha detyrimet e programit mësimor dhe ka mbrojtur mikrotezën.
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit si dhe pajisjen e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit (lënda teori komunikimi dhe legjislacioni).
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Plani mësimor nuk ka lëndë/module të teknologjisë së informacionit por nga vizita në institucion, GVJ identifikoi kapacitete të mjaftueshme [T7-salla e lab IT] ku studentët mund të përdorin teknologjinë dhe të praktikojnë njohuritë e tyre.
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Dijet e marra, aftësitë dhe kompetencat e përfituara gjatërealizimit të programit të studimit vlerësohen në përfundimin e lëndëve përkatëse me sistemin e notave ku nota 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale, ndërsa mikroteza vlerësohet me sistem pikëzimi [rregullorja e programit].
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	<i>GVJ identifikoi mospërputhje në vlerësim përsa i përket shpërndarjes së pikëve në notën përfundimtare midis syllabuseve të lëndëve dhe rregullores së provimeve.</i> Në përfundim të programit të lëndës, pedagogu organizon një përmbledhje të temave dhe çështjeve të diskutuara dhe orienton studentët për provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të

**Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.

**Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.

**Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.

tij dhe vlerësimit të dijeve [T3-takimi me studentë [T5-takimi me stafin].

Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promocionit shëndetësor, institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre.

Në këto aktivitete ftohen dhe lektorë të huaj të huaj të cilët zhvillojnë leksione të hapura në gjuhë të huaj, që asistohen me përkthyes. *Institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve [T3-takimi me studentët], [T5-takimi me stafin].*

Në programin MP në “Menaxhim infermieror” janë angazhuar pedagogë me kontratë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit që mbulon lëndët karakterizuese të kategorisë B, janë mjekë dhe infermierë specialistë të fushave përkatëse dhe kompetentë në këto fusha. Në lëndët e zhvilluara, fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës të cilën zhvillon pedagogu, duke ndikuar në cilësinë e mësimdhënies.

Programi i studimit është specifik dhe bazohet kryesisht në punën individuale të studentit.

Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet studentët në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon KUR, temave të kursit, projekte kërkimi, kryerjen e diplomës si dhe gjatë kryerjes së praktikës profesionale në institucione shëndetësore [T3-takimi me studentët].

Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e KUR si dhe asistencën nga stafi akademik, por *GVJ nuk e vërteton shembuj të zhvillimit të tyre në institucion.*

Në takimin me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se kanë si objektiv realizimin e programeve të përbashkëta me institucione jashtë vendit si Italia, për të cilat kanë rënë dakord parimisht por nuk janë nënshkruar për çështje burokracie pasi po organizojnë zgjedhje në institucionet e tyre [T1-takimi me drejtuesit].

Për këtë shkak, KUR nuk ka kuota të miratuara në programin BSc. Infermieri në vitin e parë 2019-2020 [T1-takimi me drejtuesit].

*GVJ nuk identifikoi metoda alternative të mësimdhënies ku personeli akademik në bashkëpunim me institucionet*

	<p><i>bashkëpunuese të ketë mundësuar apo rritur mobilitetin e studentëve.</i></p> <p>Në këtë drejtim, <b>GVJ rekomandon që institucioni të vërë në zbatim marrëveshjet e nënshkruara me partnerët e huaj për të rritur mobilitetin e stafit dhe studentëve të programit të studimit (Standardi III.7).</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<p>Për realizimin e praktikës profesionale institucioni ka lidhur një sërë marrëveshesh dhe u siguron studentëve të kryejnë praktikën profesionale në institucione shëndetësore publike dhe private [<b>marrëveshjet kombëtare</b>].</p> <p><i>GVJ e konsideron dhënien e mundësive për studentët të zbatojnë njohuritë e tyre në qendrat spitalore e shëndetësore si pikën më të fortë të këtij programi studimi.</i></p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh nga afër me laboratorin e infermieristikës ku studentët provojnë aftësitë dhe dijet e marra në auditor.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	<p>KUR garanton kryerjen e praktikës profesionale në institucione shëndetësore publike dhe private në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me to duke ju krijuar mundësi studentëve të fitojnë shprehitë e punës praktike dhe të familjarizohen me to si dhe të krijojnë kontakte me stafin mjekësor dhe infermieror duke bërë të mundur dhe realizimin e mikrotezës së diplomës. Institucioni ka eksperiencë pozitive në realizimin e praktikave në spitalin e Vlorës. Studentët kryejnë praktikën jo vetëm në spital por dhe në strukturat e shërbimit parësor, pranë mjekut të familjes [<b>përfitimet nga marrëveshjet</b>].</p>
<b>Kriteri 3.</b> Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	<p>Programi i studimit MP në “Menaxhim infermieror” ka 60 ECTS, përfshirë dhe praktikën profesionale. Praktika realizohet në bazë të syllabusit të miratuar si dhe udhëzuesit të praktikës profesionale. Vlerësimi përfundimtar kryhet nga pedagogu mbikëqyrës dhe institucioni pritës dhe dokumentohet në librin e praktikës që u vu në dispozicion gjatë vizitës në institucion.</p> <p><b>Nga sa më sipër, GVJ identifikoi praktikë të mirë krijimin e mundësive për studentët për realizimin e praktikave</b></p>

	profesionale në qendrat spitalore dhe shëndetësore (Standardi III.8).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studenti në fund të studimeve pajiset me diplomëMP në “Menaxhim infermieror” pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor dhe ka mbrojtur mikrotezën. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e diplomimit të miratuar me vendim të senatit akademik[rregullorja e diplomimit].Institucioni ka përgatitur një udhëzues i cili mbart informacionetë detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës ( <i>dokumenti duhet të rishihet pasi mbart informacione nga një institucion tjetër</i> ) [udhëzuesi i hartimit të diplomës].
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët, ndihma e të cilëve konsiston në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, prezantim e materialit, etj[ <b>lista e studentëve dhe udhëheqësve</b> ], [shembull teme diplome].
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Ky testim bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit duke përfshirë lëndët në bazë të peshës specifike të tyre në program. Vlerësimi në provimin përfundimtar kryhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 5 vetë të miratuar nga dekani i fakultetit[ <b>komisione vlerësimi</b> ],[ <b>fletë provimi diplome</b> ].
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Tema e diplomës zgjidhet nga studentët në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës eksperimentale të temës së diplomës kabinetet dhe laboratorët mësimor si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi[ <b>të dhëna për infrastrukturën</b> ], [marrëveshjet kombëtare].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Studentët ndihmohen nga pedagogu udhëheqës në punimin e temës së diplomës, nxjerrjen e rezultateve, zgjedhjen e literaturës së nevojshme. Udhëheqësi i temës garanton vërtetësinë dhe
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe	

shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	cilësinë e rezultatit dhe jep miratimin për paraqitjen e temës në komisionin e vlerësimit [ <b>udhëzuesi i diplomës</b> ].			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Mbrojtja e temës së diplomës bëhet përpara jurisë së komisionit të ngritur nga Dekani i fakultetit, e cila e vlerëson studentin me notë, bazuar në punën e tij dhe vlerësimin e udhëheqësit të temës. Studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj KUR [format diplome dhe suplementi]. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti pajiset dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e dytë të studimeve në MP “Menaxhim infermieror” [dosja e programit].			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet [rregullore e sistemit të menaxhimit të informacionit].			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

#### 4. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se KUR disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit “MP në Menaxhim infermieror”, koordinatorin për organizimin e programit të studimit, i cili është PAE. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik[<b>dosje personeli</b>].</p> <p>Institucioni (koordinatori i programit) disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore si dhe personelin administrativ.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit, GVJ, konstatoi se ka mospërputhje midis listës së stafit akademik për periudhën 2015-2020, me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit [<b>ngarkesa mësimore</b>], [<b>orari mësimor</b>], [<b>CV të stafit të dorëzuar</b>]. Gjithashtu, nuk janë vënë në dispozicion të gjitha CV e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Konstatimi i mos qëndrueshmërisë së stafit të evidentuar në fushën dy, evidentohet edhe në standardin IV.1. Personeli akademik nënshkruan kontrata vjetore dhe nuk ka një ndarje të qartë midis kontratës së punës së PAE/PAK pasi kohëzgjatja e tyre është 1 vjeçare [<b>kontrata te personelit PAE/PAK</b>].</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p><i>Institucioni nuk ka një procedurë të qartë për kategorizimin e personelit akademik sipas përcaktimeve të LAL dhe Udhëzimit 29 të MASR për ngarkesën mësimore në IAL.</i></p> <p>Nga sa më sipër, GVJ rekomandon hartimin e një procedure të qartë e cila spjegon dhe zbaton përcaktimet e LAL dhe Udhëzimit 29 për ngarkesën mësimore për personelin akademik (Standardi IV.1).</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p><b>Institucioni të shohë mundësinë e kategorizimit të kontratave të punës në përputhje me Udhëzimet e MASR, Kodin e Punës dhe aktet e veta rregullatore, por njëkohësisht të marrë parasysh përcaktimet ligjore të ligjit të arsimit të lartë në lidhje me kategoritë e personelit akademik në IAL (Standardi IV.1).</b></p> <p>Këto masa mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë për kategorinë PAE. <b>Paralelisht, institucioni, të angazhohet në plotësimin dhe</b></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	

<p>strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p><b>përditësimin e dokumentacionit të personelit, veçanërisht CV dhe aktivitetit të tyre kërkimor e shkencor.</b></p> <p>Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ, u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës për PAE, PAK. GVJ verifikoi dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë.</p> <p>Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve dhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga KUR <b>[procedurë rekrutimi për personelin]</b>. Kontratat rinovohen për çdo vit akademik. Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga KUR. <i>Në kontratë nuk është përcaktuar se në cilin departament apo program është punësuar pedagogu si dhe ngarkesa mësimore që ai realizon në vitin akademik.</i></p> <p>Në diskutimin me pedagogët u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Ata referuan se pagesa e personelit akademik bëhet në bazë të ngarkesës mësimore që realizojnë.</p> <p>Në dosjet e personelit apo në dokumentet e vëna në dispozicion nga ana e institucionit (për këtë program studimi) <i>janë përfshirë pjesërisht elementët e Udhëzimit Nr. 29, datë 10.09.2018“Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”</i>, i cili përcakton mekanizmat për llogaritjen e ngarkesës vjetore të punës për personelin me kohë të plotë e të pjesshme sipas kategorive të personelit akademik <b>[kriteret e shpërndarja e ngarkesës]</b>.</p> <p>Rekrutimi i stafit akademik bazohet në aktet ligjore në fuqi. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit <b>[procedurë rekrutimi për personelin]</b>. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik; procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi <b>[T1-takimi me drejtuesit], [T6-takimi me NJSBC]</b>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>KUR ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin e KUR me qëllim kryerjen në mënyrë profesionale të detyrave të tyre <b>[të dhëna për infrastrukturën]</b>. Nga takimi me personelin akademik, personeli shprehet se Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre <i>por ndërkohë nuk u evidentuan raste konkrete të zhvillimit profesional dhe akademik të personelit të institucionit (veçanërisht për programin MPMI, që mbulon dhe administron programin e studimit)</i><b>[T5-takimi me stafin]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Institucioni deklaron se ka kryer aktivitete shkencore dhe leksione të hapura, pjesëmarrje të stafit akademik dhe studentëve në aktivitetet shkencore kombëtare apo vizita shkëmbim eksperience me institucione analoge në Itali në funksion të kualifikimit profesional të personelit akademik. <i>Institucioni nuk disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve.</i> Aktivitetet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional, për njohjen e stafit me teknologjitë e reja dhe zbatimin e tyre në procesin mësimor deklarohet se zhvillohen.<i>porGVJ nuk eidentoi zbatimet e këtyre metodologjive në procesin mësimor</i><b>[T5-takimi me stafin], [T3- takimi me studentët]</b>apo në veprimtari të tjera akademike.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p><b>GVJ rekomandon që institucioni të angazhohet në krijimin e mundësive për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik në aftësimin pedagogjik, në përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe teknologjisë (Standardi IV.2).</b> Drejtuesit e institucionitushprehën gjatë vizitës në institucion se hasin vështirësi në rekrutimin e personelit të kualifikuar në këtë program studimi <b>[takimi me drejtuesit]</b>.Vështirësia lidhet me numrin e vogël të specialistëve në rajonin e Vlorës dhe pamundësinë e rekrutimit të stafit nga qytetet e tjera për shkak të largësisë fizike.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentacionit, vihet re ulje e numrit të PAE në vite në këtë program studimi<b>[tëdhënapër stafin akademik ne departament dhe programin e studimit]</b>.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi IV.3**

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Mjediset, infrastruktura, teknologjia e informacionit, biblioteka, shërbimet për studentët, janë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi normal mësimor.</p> <p>Në dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimorë, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin, bibliotekë si dhe hapësirë të jashtme në ambiente të tjera dhe parking.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni disponon sistem ngrohje-ftohje qendrore, sistem sigurimi pa ndërprerje të energjisë elektrike, nyjehidrosanitare, sistem tëmbrojtjes kundra zjarrit, sistem sigurie dhe vëzhgimi të ambienteve të cilat u verifikuan dhe gjatë vizitës në institucion <b>[të dhëna për infrastrukturën]</b>. GVJ vizitoi auditorët mësimorë të cilat ishin të pajisura me video-projektor, kompjuter të lidhur me internet dhe tabela. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Këtë vit akademik institucioni ka zgjeruar kapacitetin pritës me ambiente të reja (kati -1) në të njëjtën godinë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>KUR ka vënë në dispozicion të procesit mësimor 2 laboratorë dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimeve<b>[T7-vizita në ambiente]</b>.</p> <p>Institucioni disponon laboratorë mësimorë mjekësore dhe kabinete në funksion direkt të zhvillimit normal të programit mësimor, si kabineti i fizioterapisë, i infermierisë, laborator i anatomisë, fizikës, informatikës dhe kimisë <b>[të dhëna për infrastrukturën]</b>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Pajisjet e mjedisëve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me video projektor dhe me pajisjet e tjera të nevojshme<b>[T7-vizita e ambienteve]</b>.</p> <p>Laboratorët mësimorë përmbajnë aparaturat dhe mjetet e tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit.</p> <p>Institucioni ka të instaluar një laborator informatike të pajisur me kompjutera dhe programe profesionale në përputhje me programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e</p>	<p>Për kryerjen e orëve të praktikës profesionale sipas programit të studimit KUR ka në zbatim marrëveshje bashkëpunimi me institucione të shërbimit shëndetësor parësor dhe spitalor <b>[marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtare]</b>.</p> <p><i>Nga sa më sipër, GVJ vlerëson kapacitetet infrastrukturore dhe logjistike në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies.</i></p>

praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni disponon një sallë biblioteke të pajisur me 20 vende leximi dhe vendi interneti të pajisura me kompjutera. Biblioteka disponon botime/titujsh librash profesional. Staf i akademik dhe studentët dispononin adresa të brendshme email-i [ <b>rregullore e menaxhimit të sistemit të informacionit</b> ]. Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Në bibliotekë arkivohen kopjet e revistës së botuar nga ana e institucionit dhe periodikë të tjerë [ <b>T7-vizita e ambienteve</b> ]. <i>Në RVB dhe në dokumentacionin bashkëngjitur, nuk jepen detaje mbi listën e botimeve në fushën e mjekësisë.</i> Nisur nga numri i studentëve në programin e studimit, biblioteka është e mjaftueshme dhe përballon kërkesat e tyre. Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë vizitës në institucion u deklarua se KUR e pasuron çdo vit bibliotekën me literaturë mjekësore dhe jo mjekësore, bashkëkohore, të cilat bëhen publike për stafin dhe studentët [ <b>lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka është e pajisur me vende interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjatë vizitës në institucion u deklarua se KUR e pasuron çdo vit bibliotekën me literaturë mjekësore dhe jo mjekësore, bashkëkohore, të cilat bëhen publike për stafin dhe studentët [ <b>lista e teksteve/periodikëve në Bibliotekë</b> ].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara dhe janë në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. Institucioni nuk ka punonjës të veçantë për bibliotekën.
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	<b>Megjithatë, institucioni duhet të krijojë kushte për akses të në bibliotekat on-line të fushës mjekësisë të cilës i përket dhe programi i studimit (Standardi IV.4).</b> <i>Bazuar në deklaratimet e studentëve dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kjo mbështetje nga ana e institucionit mungon [T3, takimi me studentët].</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të	

detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.				
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në dokumentacionin mbështetës, institucioni ka paraqitur një dokument i cili tregon mekanizmat e ruajtjes dhe administrimit të informacionit në KUR <b>[rregullore e menaxhimit të informacionit]</b> . Ndërsa në RVB, plotësimi të këtij kriteri, Institucioni i referohet rregullores së sekretarisë mësimore <b>[rregullorja e sekretarisë mësimore]</b> . <i>Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni nuk ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili të funksionojë në bazë të rregullores të sipërcituar (Standardi IV.5).</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni nuk ka një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit, prandaj GVJ nuk mund të analizojë përmbushjen e kriteve lidhur me këtë sistem në këtë standard.  Institucioni disponon faqen e tij të internetit <b>[www.unireald.edu.al]</b> e cila përmban informacione të vlefshme për informimin e publikut. Faqja e internetit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe.
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe	

studentët e programit të studimit.	Informacionet në lidhje me programet e studimit, përmbajtjen, strukturën/organigramën duhet të publikohen dhe përditësohen në kohë reale.			
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.				
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.				
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X		

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Menaxhimi financiar i Institucionit është i lidhur me aktivitetin e bizneseve, pjesë e shoqërisë themeluese. Financat e institucionit administrohen nga Bordi i Administrimit. Referuar Statutit të KUR [statuti KUR], institucioni çdo vit harton buxhetin bazuar në propozimet e njëjësive dhe strukturave të kolegjit. <i>GVJ-së nuk iu vunë në dispozicion të dhëna mbi procedurën e hartimit të buxhetit, alokimit dhe realizimit e tij në nivel institucional dhe të programit të studimit.</i> Nga takimi me përfaqësuesit e Bordit, u deklarua se ky proces realizohet [T8-takim me ZBNJ & ZF].
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit,	Në dokumentet e vëna në dispozicion të këtij procesi [raporti financiar vjetor], [plan financimi] jepen të dhëna financiare të detajuara në lidhje me aktivitetin e shoqërisë, shpenzime operative, por informacioni nuk është përmbledhur në formën e

<p>shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p><i>një raportimi analitik në funksion të realizimit të aktivitetit akademik për institucionin dhe programin e studimit.</i></p> <p>Referuar deklarimeve të Bordit të Administrimit, pavarësisht së kostot janë më të mëdha se përfitimet që sjell programi i studimit, garanton ecurinë e tij nëpërmjet mbështetjes nga shoqëria themeluese. Referuar Raportit vjetor 2017-2018 [<b>raporti vjetor 17-18, financimi</b>], institucioni deklaroi se shpenzimet totale përbejnë rreth 63% të të ardhurave të institucionit. <i>Edhe në RVB, informacioni mbi analizën financiare për mbarëvajtjen dhe ecurinë e programit të studimit është jo i plotë.</i></p> <p><b>Nga sa më sipër GVJ rekomandon hartimin e raporteve periodike financiare në nivel institucional në të cilin paraqiten të dhëna mbi kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një vit akademik (Standardi IV.6).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>KUR është një institucion jopublik i arsimit të lartë dhe si i tillë ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentet shoqëruese deklarohet se burime të financimit janë tarifat e studentëve (regjistrimit dhe shkollimit) dhe 27% e buxhetit financohet nga kompania mëmë. Përdorimi i fondeve ka shkuar në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, investimit në laboratorë dhe auditorë, shtimit të titujve në bibliotekë, proceseve të informatizimit, punësimit të stafit akademik të kualifikuar, financimit të veprimtarive shkencore, <i>por nuk ka informacion të detajuar për shpërndarjen e fondeve sipas zërave të caktuar.</i></p> <p>Institucioni kryen audite financiare në zbatim të kuadrit ligjor financiar në fuqi në RSH.</p> <p><i>Në raportin financiar të paraqitur mungon një pasqyrë të hollësishme financiare e të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</i></p> <p><i>GVJ nuk identifikoi analiza mbi të cilat të jenë hartuar politika apo ndërhyrjet e posaçme në buxhet për diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij për vitet në vijim.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takim me drejtuesit dhe administratorin e KUR u deklarua se institucioni nuk është me fitim, por investimet i bazojnë në studimin e tregut të punës, kërkesat në rritje për infermierë për shkak të largimit të stafit infermieror në emigracion, duke përmbushur dhe misionin e KUR për të shërbyer vendit në plotësimin e nevojave për personel infermieror. <i>Pavarësisht se drejtuesit deklarojnë se institucioni ka mbështetje financiare, të ardhurat e pamjaftueshme nuk</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion në takim me drejtuesit dhe administratorin e KUR u deklarua se institucioni nuk është me fitim, por investimet i bazojnë në studimin e tregut të punës, kërkesat në rritje për infermierë për shkak të largimit të stafit infermieror në emigracion, duke përmbushur dhe misionin e KUR për të shërbyer vendit në plotësimin e nevojave për personel infermieror. <i>Pavarësisht se drejtuesit deklarojnë se institucioni ka mbështetje financiare, të ardhurat e pamjaftueshme nuk</i></p>

ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<p>garantojnë ecurinë afatgjatë të institucionit dhe programit të studimit në veçanti.</p> <p>GVJ rekomandon që institucioni të analizojë me hollësi kapacitetet e veta financiare, të ardhurat, shpenzimet dhe të hartojë një strategji të re zhvillimi e cila të garantojë të ardhura të tjera dhe ecuri financiare pozitive nëpërmjet shërbimeve, projekteve etj (Standardi IV.6)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## 5. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUR është institucion jo publik i cili bazon aktivitetin e tij në bazën ligjore aktuale në fuqi. Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e kolegjit ( <i>të cilat duhet të përditësohen</i> ). Edhe për administrimin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, në këto akte janë parashikuar procedurat e regjistrimit, mësimdhënies, transferimit, vlerësimit dhe diplomimit [rregullore e sekretarisë], [rregullore provimi], [rregullore zyrës së këshillimit të karrierës].
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Studentët deklarojnë se institucioni zhvillon procedura transparente duke siguruar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit [T3-takimi me studentët]. Studentët kanë deklaruar se “duhet të ketë më shumë kërkesë llogarie nga ana e institucionit për raste të caktuara por gjithashtu edhe vetë studentët duhet të jenë më të përgjegjshëm dhe vetëkritikë”.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë	Në fazat e regjistrimit, institucioni publikon kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve [faqja e internetit KUR]. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga një komision i caktuar nga dekanati mbështetur në dokumentacionin e paraqitur, notës mesatare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave dhe Vendimeve

lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	të Senatit Akademik[rregullore e programit].Në takimin me përfaqësues të fakultetit dhe departamentit u deklarua që aplikohen kritere përzgjedhëse për regjistrimin në master profesional por GVJ nuk identifikoi raste të aplikimit të këtyre kritereve[T1-takimi me drejtuesit].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Përgjatë vitit akademik, institucioni ndjek ecurinë e studentëve në programin e studimit[të dhëna për notat e studentëve hyrjedalje].Referuar analizës së bërë nga ana e institucionit rezultoi se rezultatet e studentëve në master profesional janë më të larta se në bachelor.			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Procedura e transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme është e mundur, por në programin e studimit nuk ka patur raste. Vlerësimi i dijeve është i paraqitur në rregullore të ndryshme [rregullorja e programit] dhe syllabuset e lëndëve. Në takimin me drejtuesit u theksua se institucioni aplikon kritere përzgjedhëse për programin e studimit. Nuk u evidentuan raste për sa kohë numri i regjistrimeve është më i vogël se numri i kuotave të kërkuara nga ana e institucionit[kuota e pranimit 19-20]. Vetëm për vitin 2019-2020 institucioni ka kërkuar 30 kuota në këtë program studimi. Informacioni i publikuar në faqen e internetit lidhur me programet, regjistrimet etj, është i mjaftueshëm dhe orientues. Po ashtu, shumica e rregulloreve janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit[faqja e internetit KUR]. Informacioni për regjistrimet jepet edhe nëpërmjet broshurave të përgatitura për maturantët, javët e informimit etj.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni informon studentët në lidhje me procedurat e pranimit. Ato janë publike dhe të aksesueshme nga të gjithë. Programi i studimit zgjat një vit akademik e për rrjedhojë nuk ka kritere të kalimit nga njëri vit në tjetrin[dosja e programit]. Në rregulloren e përgjithshme, nenet 54, 55 dhe 56 tregohen modalitetet e transferimit në programet e tjera të KUR, njohja e studimeve etj[rregullore KUR].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	Për procedurat e transferimeve, me vendim të rektoratit ngrihet komisioni përkatës në nivel Kolegji. Përbërja e komisionit



procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	ndryshohet me vendim të rektorit. Në çdo departament, me urdhër të dekanit, ngrihen komisionet e ekuivalentimit dhe vlerësimit të cilat miratohen prej tij. Të gjitha llojet e transferimeve bëhen mbi bazën e kërkesës së studentit duke plotësuar një formular tip. Ky formular publikohet në faqen zyrtare të Kolegjit së bashku me informacionin e nevojshëm. Kërkesa për transferime pranohen dhe administrohen në Sekretarinë mësimore gjatë gjithë viti akademik, deri në 10 shtator të çdo viti, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga aktet e tjera nënligjore <b>[rregullore KUR]</b> .			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Vlerësimi i studentëve është paraqitur në Rregulloren e përgjithshme (Kreu VII kontrolli i dijes), rregulloren e programit dhe syllabuset e lëndëve ose moduleve. <i>GVJ ka identifikuar mospërputhje në metodologjinë e vlerësimit midis rregulloreve dhe syllabusevepërsa i përket % që zë vlerësimi gjatë vitit akademik dhe vlerësimi përfundimtar ose provimi</i> <b>[rregullore e programet], [syllabuset e lëndëve]</b> .			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni ka hartuar një rregullore diplomimi e cila përmbledh informacionet që studenti duhet të ketë parasysh gjatë studimeve të tij <b>[rregullore diplomimi]</b> . <i>Komisionet e diplomimit përbëhen nga 5 anëtarë por GVJ identifikoi proces verbale ku komisioni/juria përbëhet nga 3 anëtarë</i> <b>[procesverbal diplomimesh]</b> .			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Studentët e këtij programi pasi shlyejnë detyrimet, mbrojnë një temë diplome. Për modalitetet e shkrimit të saj, institucioni ka hartuar një udhëzues me udhëzime për studentët. Në takimet me drejtuesit, u theksua se KUR informon vazhdimisht studentët e rinj në lidhje me institucionin, personelin dhe infrastrukturën që ai disponon <b>[T1-takimi me drejtuesit]</b> . KUR publikon broshura informimi dhe informacione të vlefshme në faqen e internetit <b>[poster informimi]</b> .			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht X

### Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët e programit të studimit informohen nga personeli akademik, sekretaria mësimore për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve <b>[T3-takimi me studentët]</b> .

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Programi i studimit dhe plani mësimor përmbajnë informacionin me kohëzgjatjen e studimeve dhe ngarkesën në orë dhe kredite[<b>dosja e programit</b>], [<b>plani mësimor</b>]. KUR vë në dispozicion të studentëve informacione dhe dokumente për zhvillimin e lëndëve/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Syllabuset tregojnë shkurtimisht detyrimet e studentit në lidhje me lëndën/modulin.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Studentët e programit të studimit MPMI rezultojnë të jenë të kërkuar në tregun e punës në rajonin e Vlorës. Shumica e tyre ishin në marrëdhënie pune në institucione të ndryshme shëndetësore. <i>Mbi mundësitë e punësimit të tyre, institucioni deklaroi se ka një zyrë karriere e cila nuk rezultoi të ketë aktivitet ose produkt të matshëm.</i> Në takimin me studentët, u evidentua se ngaqë shumica janë në marrëdhënie pune, nuk e kanë patur të nevojshme ndihmën e zyrës. Në rregulloren e zyrës [<b>rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës</b>], institucioni deklaroi se procesi i zhvillimit dhe këshillimit të karrierës është i lidhur ngushtësisht me formimin akademik të studentëve, të ardhmen e të cilëve institucioni e sheh të lidhur me mundësinë e punësimeve në institucionet jashtë vendit, falë bashkëpunimit të ngushtë me Universitetin e Salernos, por njëkohësisht studentëve ju krijohet mundësia që nëpërmjet iniciativave publike e private, konferencave, leksioneve të hapura, serive të diskutimeve dhe debateve periodike, projekteve studentore në partneritet, si dhe përmes një numri të madh aktivitetesh ekstra- kurrikulare, jo vetëm të përgatiten profesionalisht, por të kenë qasjen korrekte ndaj botës akademike, duke formuar një profil akademik individual, i cili do t'ju vlejë në karrierën e nesërme, por edhe në studimet e mëtejshme [<b>rregullore e zyrës së këshillimit të karrierës</b>].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p><b>Nga sa më sipër, referuar objektivave dhe synimeve të paraqitura, GVJ rekomandon që të asistojë studentët në të gjitha veprimtaritë jashtë kurrikulare dhe të punësimit me qëllim integrimin e shpejtë të tyre në tregun e punës (Standardi V.3).</b> Studentët deklarojnë se kanë informacionin dhe mbështetjen nga ana e institucionit. Edhe pse në takim kanë qenë vetëm 4 studentë, rezultoi se ata janë të kënaqur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Nga ana tjetër, studentët kërkojnë nga institucioni që të jetë më kërkuar ndaj studentëve [<b>T3-takimi me studentët</b>]. <i>Institucioni nuk disponon sistem të menaxhimit të brendshëm i cili të lehtësojë komunikimin me studentët e programit dhe personelin akademik.</i> Institucioni ofron për studentët e-maile dhe informim</p>

	të drejtpërdrejtë [T4-Sekretaria mësimore], [T3-takimi me studentët].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë\*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Sekretaria mësimore mbledh dhe mban të dhëna në formë elektronike (Excel) për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Në tre vitet e fundit në programin e studimit janë diplomuar përkatësisht, 2, 8, 3 studentë <b>[studentë të diplomuar]</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nisur nga numri i ulët i studentëve, aktualisht kjo mënyrë e mbajtjes së të dhënave është efiçente por <b>në të ardhmen institucioni duhet të krijojë infrastrukturë IT për administrimin dhe menaxhimin e të dhënave të studentëve në sekretarinë mësimore [T7-vizita e ambienteve]</b> . Gjithashtu, sekretaria mësimore disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit. Nga verifikimi i dokumentacionit në letër (hard-copy), <i>GVJ identifikoi disa pasaktësi që lidhen me mungesa në dokumentacion, mungesë të numrit të matrikullimit apo pasaktësi në plotësimin e regjistrimit themeltar [T7-vizita e ambienteve, sekretaria mësimore]</i> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Konkretisht: – 2014-2015: 20 studentë (4 pa numër matrikullimi); – 2015-2016: 10 studentë (1 pa numër matrikullimi dhe 3 të çregjistruar); – 2016-2017: 9 studentë të regjistruar (1 pa numër matrikullimi); – 2017-2018: 28 studentë të regjistruar (4 pa numër matrikullimi); – 2018-2019: 11 studentë të regjistruar (3 pa numër matrikullimi dhe 2 të çregjistruar); – 2019-2020: 8 studentë të regjistruar;
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<i>GVJ argumentoi mungesën e numrave të matrikullimit me komunikimin e vazhdueshëm me QSHA dhe MASR dhe vonesat e krijuara. Të diplomuarit nuk janë të shënuar në regjistër. Gjatë vizitës u evidentua se në institucion studiojnë edhe studentë të</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të	

studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

*huaj (jo në programin MPMI) të cilët po ashtu janë të pa pajisur me numër matrikullimi.*

*Në regjistrin themeltar u evidentuan disa parregullsi në plotësimin e tij p.sh vende bosh, shënime me laps, mos reflektim i plotë i notave të procesverbaleve, etj.*

Në rastet e largimeve para përfundimit të programit apo mos përfundimit me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, studentët tërheqin dokumentacionin e nevojshëm.

Nga sa më sipër, Sekretaria e institucionit mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin nga pranimi në diplomim por *ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit zyrtar nuk është i standardizuar dhe i informatizuar.*

**GVJ rekomandon që institucioni të fokusohet në zhvillimin dhe përdorimin e programeve ose sistemeve që administrojnë dhe ruajnë të dhëna të rëndësishme të personelit akademik dhe studentëve (Standardi V.4).**

**Institucioni duhet të standardizojë hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar në përputhje me bazën ligjore dhe aktet nënligjore (Standardi V.4).**

Institucioni arkivon rezultatet e të nxënit. Procesverbalet e provimeve ruhen në sekretarinë mësimore. Provimet dhe testimet realizohen me komisione por *GVJ identifikoi raste ku procesverbalet ishin të firmosura vetëm nga një anëtar [lista e studentëve të diplomuar].*

Institucioni nuk ka një sistem të brendshëm për menaxhimin e informacionit, referuar kriterit 4 të këtij standardi.

KUR ka vënë në dispozicion të GVJ disa të dhëna përmbledhëse mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar [**lista e studentëve të diplomuar**] dhe mesataret në përfundim të studimeve (shkollë e mesme, Bsc, MP).

Në raportin vjetor 2017-2018, institucioni ka deklaruar se raporti synon të:

- vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të Kolegjit në përputhje me standardet;
- kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve,

*por që nuk reflektohet në përmbajtje të tij lidhur me profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.*

*Analiza e detajuar me treguesit e Standardi V.4, mungon.*

	<i>Kjo pasi Raporti vjetor, nuk është hartuar sipas dhe në orientimet e paraqitura në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018 të Ministrisë të Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR) “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor afatit...”.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në dokumentet kryesore të institucionit (statuti, rregullorja e përgjithshme etj), studentët janë të përfshirë në strukturat vendimmarrëse të KUR. Studentët janë të organizuar në strukturat studentore në nivel fakulteti dhe në nivel kolegji. Edhe në takimin me studentët ata deklarojnë se janë të përfshirë dhe pyeten nga drejtuesit e institucionit <b>[T3-takimi me studentët]</b> . Përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është e mundur bazuar në aktet rregullatore. <i>GVJ e ka patur të vështirë të identifikojë realisht me raste konkrete nëse kjo formë përfshirje ka qenë frytdhënëse. Nga takimi me studentët rezultoi se ata kishin mungesë informacioni në lidhje me administrimin e institucionit dhe vendimmarrjes. Edhe raportin e vlerësimit të brendshëm rezultoi që ata nuk e kishin lexuar. Gjithsesi, ky tregues është i vështirë për tu matur pasi institucioni nuk ka paraqitur të dhëna rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme sikundër e kërkon standardi. Informacioni i paraqitur në RVB mungon [RVB fq. 32].</i> <b>GVJ sugjeron që institucioni të evidentojë mekanizmat e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje dhe jetën akademike të kolegjit, të analizojë dhe marrë parasysh propozimet dhe kontributet e tyre dhe ti bëjë ato publike (Standardi V.5).</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<i>Përmirësimi i programeve të studimit, rezulton të mos jetë bërë në konsultim me studentët dhe duke parasysh ngarkesën akademike të tyre në këtë program studimi (raportet e ndryshimit të ngarkesës në dy semestra, fusha 3) dhe parashikimin e procedurave jo burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave burokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p><b>GVJ propozon që gjatë fazës së rishikimit të kurikulës, të përfshihen studentëve dhe ku është e mundur të reflektohen sugjerimet dhe propozimet e tyre.</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Ndërkohë, lidhur me komunikimin dhe respektimin e të drejtës për të dhënë mendime, duket se studentët e kanë këtë lirshmëri. Në takimin me studentët, ata shprehin se kanë bashkëpunim të ngushtë me personelin akademik dhe se atyre u mundësohet dhënia e mendimit gjatë procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës [T3-Takimi me studentët].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p><b>Standardi V.6</b>  <b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p><i>Institucioni nuk ka hartuar procedura specifike në shërbim të studentëve. Bazuar në deklaratimet e studentëve, ata e marrin informacionin e nevojshëm nga sekretaria mësimore [T3-takimi me studentët].</i>  <i>Institucioni nuk ka një strukturë të posaçme për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Këtë rol e kryen sekretaria mësimore e cila ndjek ecurinë e studentëve gjatë vitit akademik. Studentët marrin në këtë strukturë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe dokumente që iu nevojiten.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p><i>Në rregulloren e përgjithshme [rregullorja KUR], si strukturë ekziston zyra për këshillimin e karrierës. Sikundër u theksua më lart, si nga studentët edhe nga dokumentacionin në dispozicion, rezultojnë se është sekretaria mësimore struktura që mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike. Informacioni i</i></p>

**Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.

**Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.

dhënë është kryesisht për orientimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor, orientimin për praktikën profesionale etj. Orientimi drejt tregut të punës më së shumti realizohet nëpërmjet kontakteve apo njohjeve individuale që personeli akademik ka. Referuar gjetjeve dhe konstatimeve nga ana e grupit të vlerësimit të jashtëm rezultoi se për Standardin V.6, *KUR nuk disponon procedura e struktura të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët. Shumica e veprimtarive janë të organizuar me komisione ad-hoc dhe nuk përfaqësojnë struktura të përhershme.*

Nga sa më sipër, **GVJrekomandon që institucioni të bëjë funksionale Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit e cila të hartojë dokumentacionin e nevojshëm e më pas të ndjekë studentin brenda dhe jashtë institucionit (Standardi V.6).**

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## 6. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b></p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>KUR ka të ngritur në nivel institucional Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) e cila funksionon në bazë të statutit dhe rregullores [statut KUR], [rregullore KUR].</p> <p>Zyra ka rregulloren mbi të cilën bazon aktivitetin e saj [rregullore NJSBC]. NJSBC të rishohë rregulloren e saj në përputhje me misionin dhe objektivat e njësisë dhe të përcaktojë qartë fushën e veprimtarisë.</p> <p>Në objektivat strategjikë të zhvillimit të institucionit [strategjia KUR, fq-5], janë parashikuar veprimtaritë: 1. për zhvillimin institucional, për përmirësimin e programeve dhe stafin akademik, partneriteti me të huaj, implementimi i programeve të studimit dhe kërkimi shkencor. <i>Në këtë strategji ka elementë të përmirësimit të cilësisë por GVJ vë re se ky objektivi është përfshirë në strategjinë e zhvillimit dhe jo si strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Për rrjedhojë, nën objektivat madhorë të strategjisë së zhvillimit, IAL të harmonizojë mekanizmat që sigurojnë cilësinë afatgjatë në institucion në përputhje me standardet e cilësisë(Standardi VI.1).</i></p> <p><i>Për më tepër, përfshirja e aktorëve të tjerë si studentët dhe ekspertët e jashtëm të mos jetë thjesht një përmbushje kriteri por kontributi i tyre të jetë real. Nga takimi me studentët rezultoi se ata e njohin shumë pak ose aspak procesin e sigurimit të cilësisë si dhe përmbajtjen e RVB[T3-takimi me studentët].</i></p> <p>Studentët dhe partnerët e jashtëm do të ndihmonin gjithashtu në rishikimin e mekanizmave dhe hartimine një rregulloreje të re. <i>Proceset aktuale të sigurimit të cilësisë nuk realizohen mbi bazën e plotësimit të standardeve dhe kriterëve të cilësisë. NJSBC më së shumti është angazhuar në procese ad-hoc sesa në ngritjen dhe konsolidimin e sistemit të brendshëm i cili do të ndihmonte</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p><i>çdogrup të jashtëm monitorimi, vlerësimi, auditimi apo kontrolli që vjen nga jashtë KUR.</i></p> <p><b>NJSBC duhet të japë kontributin e saj në këtë drejtim për realizimin e proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë (Standardi VI.1).</b></p> <p>GVJ identifikoi se procesi i vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit të programit nuk është kryer për të ndihmuar vlerësimin e jashtëm, pasi si RVB edhe dokumentacioni mbështetës nuk japin informacionin e nevojshëm dhe të paraqitur në mënyrën e duhur që të ndihmojnë ekspertët në nxjerrjen e vlerësimeve dhe gjykimeve sa më reale.</p> <p>Edhe proceset që kryhen gjatë vitit akademik të parashikuara në planin vjetor të punës, më tepër janë aktivitete të institucionit se sa një politikë e qartë me mekanizma dhe aktivitete për sigurimin e cilësisë. Në këtë drejtim <b>KUR duhet të ndjekë politika të qarta të cilat realizohen nëpërmjet procedurave periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së [plani i punës NJSBC].</b></p> <p>Këto procese të realizohen duke përfshirë të gjithë kontribuesit e institucionit që të ndihmojnë në krijimin e kulturës së cilësisë në nivel institucional.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>				
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>		

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
-----------------	-------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Procesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit/programeve të studimit <i>nuk është realizuar sipas parashikimeve ligjore dhe standardeve të cilësisë(shih fushat 1, 2).</i>Sistemi i sigurimit të cilësisë së mësimdhënies përmes rishikimit të programeve të studimit të ciklit të dytë në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm <i>nuk ka funksionuar(shih vlerësimin fusha 3).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, GVJ identifikoi rezultate të proceseve të anketimit të studentëve. Këto rezultate janë paraqitur në Raportin vjetor të institucionit 2017-2018 dhe në raportin vjetor të NJSBC [<b>raporti vjetor 2017 - 2018</b>], [<b>raporti NJSBC</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumenteve të mësipërme, grupi i punës nuk ka identifikuar problematika dhe ka arritur në konkluzionin: <i>“Rezultati i ankimit përputhet me pritshmërinë në bazë të dy pyetjeve në fund të vlerësimit në lidhje me atë që konsiderohet pozitive në Kolegjit Universitar “Reald” dhe pritshmëritë për përmirësim të mëtejshëm”.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Megjithatë, GVJ evidenton se <i>gjetjet e grupit të punës të cilat janë bazuar vetëm në mendimin dhe perceptimin e studentëve, nuk janë konfirmuar edhe nga burime alternative informacioni.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p><b>Në çdo rast, në kuadër të proceseve të sigurimit të cilësisë që realizohen nëpërmjet sondazheve, IAL duhet të përfshijë edhe metoda të tërthorta vlerësimi dhe verifikimi, të cilat sigurojnë që rezultatet e sondazheve i përfaqësojnë realitetin në të cilin ndodhet institucioni (Standardi VI.1) [pyetësori i studentëve], [RVB].</b></p> <p>Për shkak se rezultatet nga pyetësori i studentëve kanë qenë pozitive, <i>në raportin e vlerësimit nuk janë përfshirë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë[raporti NJSBC].</i></p> <p>GVJ identifikoi se <i>NJSBC por edhe strukturat e tjera të KUR kanë efikasitet të ulët në regjistrimin e informacioneve, analizës dhe raportimit ndaj titullarëve apo publikut në kuadër të informimit. Për më tepër, mungojnë rekomandime dhe plane pune që adreson përmirësimin e problematikave të evidentuara. Nga sa më sipër, rezultojnë se cilësia e raporteve është e ulët dhe nuk ndihmojnë autoritetet drejtuese të ndërmarrin masa për rritjen e cilësisë në KUR.</i></p> <p>Në këtë kuadër, GVJ, rekomandon të përmirësimit të proceseve punës të cilat lidhen me dokumentimin, analizën e informacionit apo të dhënave, raportimin dhe propozimet/rekomandimet për adresimin në të ardhmen të</p>

	problematikave që kanë nevojë të përmirësohen (Standardi VI.2).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

### Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Bazuar në raportin e NJSBC dhe nga informacioni i marrë, rezulton se vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike.</p> <p>Sikundër përmendëm më lart, <b>Institucioni duhet të verë në zbatim mekanizma gjithëpërfshirës dhe ti përdorë informacionet e mbledhura jo vetëm për vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit por edhe për vetëvlerësime periodike të performancës dhe ecurisë aftatgjatë të institucionit gjë që nuk është realizuar (Standardi VI.3).</b></p> <p>Metodat dhe instrumente të ndryshme për monitorimin dhe vlerësimin si monitorimi i mësimdhënies, realizimi i provimeve etj., u deklarua se zhvillohen në mënyrë periodike <b>[T1-takimi me drejtuesit]</b>.Edhe në planin vjetor të punës janë parashikuar aktivitete <b>[plani i punës NJSBC]</b>.</p> <p><i>Ndërsa metodat për vlerësim të cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të anës pedagogjike të mësimdhënies dhe përmbajtjes së programit dhe përputhshmërinë e tij me nevojat e studentëve, zhvillimin e metodave të të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, nuk u raportuan dhe nuk u evidentuan që kryhen.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni rezulton të ketë një nivel të kënaqshëm bashkëpunimesh referuar numrit të marrëveshjeve të nënshkruara <b>[marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare]</b>. <b>GVJ identifikoi mangësi në vënnien në zbatime të këtyre marrveshjeve në nivel kombëtar ose mungesë të dokumentimit të këtyre veprimtarive.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve</p>	<p>Institucioni rezulton të ketë një nivel të kënaqshëm bashkëpunimesh referuar numrit të marrëveshjeve të nënshkruara <b>[marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare]</b>. <b>GVJ identifikoi mangësi në vënnien në zbatime të këtyre marrveshjeve në nivel kombëtar ose mungesë të dokumentimit të këtyre veprimtarive.</b></p>

<p>apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Ndërkohë që përfshirja e aktorëve të jashtëm japin një kontribut mjaft pozitiv në realizimin e praktikave mësimore e profesionale, <i>mungon kontributi i partnerëve apo alumnit në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p>Përfshirja e tyre nëpërmjet diskutimeve për zhvillimin e programit nuk u evidentua edhe pse drejtuesit theksuan se këto takime realizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ.</p> <p>Po ashtu, edhe bashkëpunimi me punëdhënësit dhe partnerët që përfshihen në realizimin e programit nuk kanë dhënë kontribut në kuadër të përmirësimit të programit të studimit [<b>raporti analitik i marrëveshjeve</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

**Standardi VI.4**

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KUR, nëpërmjet akteve të tij si statut, rregullore, garanton përfshirjen e studentëve dhe personelit akademik si aktor të brendshëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Përfshirja e studentëve në sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit nuk rezulton në nivelin e duhur pasi <b>GVJ evidentoi që kontributi i tyre është mjaft i ulët në lidhje me informacionin që ata japin, propozimet që bëjnë dhe përgjegjësitë që marrin në lidhje me këto procese [T3-takimi me studentët].</b></p> <p>Edhe ekspertët e jashtëm janë përfshirë në grupin e punës por edhe në këtë rast <i>nuk është evidentuar ndonjë kontribut në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.</i></p> <p>Nuk ka të dhëna dhe informacione në të cilat të jenë realizuar këto përcaktime.</p> <p>Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit është garantuar nga statuti i institucionit dhe rregullorja e KUR.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nuk u evidentuan raste të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>KUR ka eksperiencë pozitive në angazhimin e personave të kualifikuar dhe profesionistëve si pjesë e personelit akademik me kontratë. Në këtë drejtim kontributi i tyre është i dukshëm në ofrimin e programit.</p> <p>Ndërsa sikundër theksuam më sipër, <b>angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj është i mangët dhe për këtë arsye kërkohet angazhim dhe angazhim më i madh nga ana e institucionit (Standardi VI.4).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Ndërsa sikundër theksuam më sipër, <b>angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj është i mangët dhe për këtë arsye kërkohet angazhim dhe angazhim më i madh nga ana e institucionit (Standardi VI.4).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Ndërsa sikundër theksuam më sipër, <b>angazhimi i bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj është i mangët dhe për këtë arsye kërkohet angazhim dhe angazhim më i madh nga ana e institucionit (Standardi VI.4).</b></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>				
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
		<p>X</p>		

<p><b>Standardi VI.5</b></p> <p><b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në faqen zyrtare të institucionit janë publikuar mjaft informacione që informojnë publikun dhe studentët e rinj. Dokumentet kryesore janë publike dhe të aksesueshme në faqen e internetit. Ka informacion të limituar në lidhje me veprimtaritë në kuadër të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë për institucionin në tërësi dhe për programin e studimit në veçanti [<b>faqja e internetit KUR</b>].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Ndërkohë që informacioni për promovimin e programeve dhe fushatat proporcionale janë të detajuara, <i>informacionet në lidhje me Institucioni rezultatet e vlerësimeve periodike të programit të studimit janë të pjesshme.</i></p> <p>GVJ nuk evidentoi raste të thyerjes së lirisë akademike apo shkelje të legjislacionit për të dhënat personale [<b>T7-vizitë zyra e burimeve njerëzore</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ ka vërejtur se në raportimet që janë kryer nga IAL nuk është evidentuar analizë e detajuar vlerësimi e cila në përfundim të shoqërohet me plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>

**Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.

*Institucioni nuk ka hartuar vlerësime, raportime, që analizojnë impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.*

*GVJ nuk identifikoi veprimtari dhe informacione që lidhen me veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.*

**Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit

**Prandaj GVJ rithekson që në kuadër të përmirësimin të treguesve të cilësisë, dhe institucioni duhet të zhvillojë më tej mekanizmat analitikë të evidentimit të performancës në nivel institucional dhe adresimit të problematikave në kuadër të përmirësimin të vazhdueshëm (Standardi VI.5).**

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

## II. PËRFUNDIME TË VLERËSIMIT TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL NË “MENAXHIM INFERMIEROR”, TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, KOLEGJI UNIVERSITAR “REALD”

### Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni disponon kapacitetet infrastrukture dhe logjistike të mjaftueshme në funksion të programit të studimit për realizimin e procesit të mësimdhënies.
2. KUR ofron mundësi të mira për studentët për realizimin e praktikave profesionale në qendrat spitalore dhe shëndetësore në rajonin e Vlorës e më gjerë.
3. Institucioni ka partneritet dhe bashkëpunime me disa institucione, të cilat, nëse vihen në zbatim sikundër është parashikuar në marrëveshjet e bashkëpunimit, do të ndihmojnë në ecurinë e mëtejshme të institucionit.
4. Afirmim konsiderohet përpjekja për të rekrutuar personel të dedikuar e përkushtuar, por, për shkak të mungesës së personave të kualifikuar, institucioni ka hasur vështirësi. KUR ka vazhduar përpjekjet për të patur personel akademik në përputhje me përcaktimet ligjore.

### Pika të dobëta:

1. Në strategjinë e tij, Institucioni nuk ka të përcaktuara qartë drejtimet kryesore të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të jenë në përputhje me fushën e veprimtarisë së KUR (**Standardi I.2**).
2. Rregulloret e KUR, të miratuara në vitin 2017, mbartin gabime dhe mbivendosje kompetencash. Për më tepër, evidentohen referenca nga legjislacioni i mëparshëm ose informacione të institucionit para riorganizimit (**Standardi I.2**).
3. Pavarësisht se personeli akademik dhe drejtuesit, në mënyra të ndryshme, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në rajonin e Vlorës, mungon një studim i mirëfilltë i tregut të punës, nevojave dhe mundësive të reja të studimit dhe punësimit (**Standardi I.3**).
4. GVJ, e mirëkupton vështirësinë që has institucioni në veprimtarinë e tij për të patur personel të kualifikuar, dedikuar e përkushtuar në çdo pozicion të strukturës, por, nga ana tjetër, rezulton që veprimtaritë që kryhen në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të mos zhvillohen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme dhe bazën ligjore në fuqi (**Standardi I.5**).
5. Organizimi, plani mësimor dhe përmbajtja e programit të studimit nuk është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi (**Standardi I.3, Standardi II.1**).
6. Drejtuesi i njësisë kryesore dhe njësisë bazë të shkencave mjekësore teknike, janë mbi limitin e moshës së lejuar për punësimin me afat të pacaktuar. Për më tepër, rolin kryesor në mbulimin e programit të studimit e luan personeli me kontratë (**Standardi II.2**).



7. Institucioni, nuk ka mekanizma të qarta të vlerësimit, motivimit dhe promovimit të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ (**Standardi II.5**).
8. Hartimi dhe miratimi i programeve të reja dhe riorganizimi/përditësimi i programeve ekzistuese dhe veprimtaritë e zhvilluara gjatë këtyre proceseve, nuk janë të dokumentuara plotësisht (**Standardi II.3**).
9. Institucioni dhe njësia përgjegjëse e programit të studimit dokumenton në mënyrë të pjesshme aktivitetin e tij (**Standardi III.1**).
10. Institucioni nuk ka një procedurë të qartë për kategorizimin e personelit akademik sipas përcaktimeve të LAL dhe Udhëzimit Nr. 29 të MASR për ngarkesën mësimore në IAL (me kohë të plotë/kohë të pjesshme, profesor/lektor/as.lektor) (**Standardi IV.1**).
11. KUR nuk ka zhvilluar ose zbatuar forma dhe metoda të tjera të përdorimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve që ndërthuren me teknologjinë, metoda inovative dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit dhe objektivat (**Standardi III.4**).
12. Institucioni nuk disponon/aplikon sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit i cili të mundësojë një sërë shërbimesh dhe funksionesh për administrimin dhe menaxhimin e proceseve dhe aktiviteteve të ndryshme (**Standardi IV.5**).
13. Për programin e studimit, mungojnë analiza dhe raporte periodike financiare ku të paraqiten të dhëna mbi kostot e programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një vit akademik (**Standardi IV.6**).
14. KUR ka burime financiare alternative të limituara përveç të ardhurave nga studentët dhe mbështetja nga shoqëria themeluese (**Standardi IV.6**).
15. Institucioni aplikon procedura jo të standardizuara në hartimin, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit zyrtar (në formë elektronike apo në letër) në përputhje me bazën ligjore dhe aktet nënligjore (**Standardi V.4**).
16. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe jetën akademike të kolegjit është në nivel të ulët (**Standardi V.5**).
17. Institucioni nuk aplikon mekanizma afatgjatë të sigurimit të cilësisë, por më së shumti procese ad-hoc dhe kontributi i NJSBC në proceset e vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera është i limituar (**Standardi VI.1**).
18. NJSBC dokumenton në mënyrë të pjesshme të dhënat që lidhen me sigurimin e cilësisë. Analizat, raportimet dhe propozimet/rekomandimet për adresimin në të ardhmen të problematikave nuk janë pjesë e raportimeve periodike (**Standardi VI.2**) (**Standardi VI.3**).
19. Nuk ka përfundime që të shoqërohen me plane masash që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara (**Standardi VI.5**).

## Rekomandime:

1. Të përditësohet strategjia e zhvillimit përshtatur me statusin aktual të KUR, fushat kryesore të veprimtarisë, programet dhe planin e zbatimit (**Standardi I.2**). Të merren në konsideratë zhvillimet e tregut global të punës dhe zhvillimet e shkencës dhe teknologjisë (**Standardi I.1**). KUR, paralelisht, të rishikojë dhe përditësojë aktet e brendshme rregullatore të Institucionit, në përputhje me Statutin dhe LAL 80/2015 (**Standardi I.2**).
2. Programi i studimit të rishikohet dhe riorganizohet brenda vitit akademik 2019 – 2020, në përputhje me aktet nënligjore, të pasqyrohen ndryshimet e miratuara nga senati (VS Nr. 52, datë 03.10.2016) në planin mësimor dhe syllabuset përkatëse (**Standardi I.3**, **Standardi II.1**). Brenda hapësirës ligjore, të merren në konsideratë orientimet që dalin nga Direktivat e Bashkimit Europian për programet e studimit në fushën e Shkencave infermiere (**Standardi I.3**).
3. Përmirësimi i programit të studimit të bazohet në të dhëna të mbledhura nga burime të ndryshme, përfshirë edhe studentët e diplomuar, të analizohen dhe të hartohet një dokument analitik me propozime konkrete në kuadër të përmirësimit të program-it/eve të studimit (**Standardi I.3**). Veprimtaritë në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit dhe bazën ligjore në fuqi (**Standardi I.5**), (**Standardi II.3**).
4. Institucioni, të vazhdojë përpjekjet për të rritur cilësinë e personelit me kohë të plotë në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe të standardeve të cilësisë (**Standardi II.2**). Paralelisht, Institucioni, të rekrutojë personel me kualifikimin, fushën akademike-kërkimore në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve të programit dhe të motivojë/promovojë ata në mënyrë që të garantojë cilësi dhe qëndrueshmëri afatgjatë të tyre në institucion (**Standardi II.5**). Institucioni, të kategorizojë kontratat e punës në përputhje me Udhëzimet e MASR, Kodin e Punës, aktet rregullatore të KUR si dhe përcaktimet ligjore të ligjit të arsimit të lartë në lidhje me kategoritë e personelit akademik në IAL (**Standardi IV.1**).
5. Institucioni, të mundësojë përdorimin e metodave inovative e pedagogjike (**Standardi III.2**), të angazhohet në krijimin e mundësive për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik në aftësimin pedagogjik (**Standardi IV.2**). Strukturat për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, të hartojnë udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit, të kryejnë dhe dokumentojnë në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin e tyre (**Standardi III.1**), (**Standardi III.4**), (**Standardi V.4**).
6. Institucioni, të verë në zbatim marrëveshjet e nënshkruara me partnerët e huaj për të rritur mobilitetin e stafit dhe studentëve të programit të studimit (**Standardi III.7**).
7. KUR, të ndërmarrë masa të cilat të garantojnë të ardhura nga burime alternative dhe që sigurojnë ecuri financiare pozitive (shërbime, projekte, etj.) (**Standardi IV.6**) si dhe të kryejë dhe hartojë raporte periodike financiare në nivel institucional.

8. Institucioni, të mbështesë (**Standardi V.3**), të bëjë funksionale zyrën e karrierës (**Standardi V.6**) dhe përfshijë studentët në vendimmarrje dhe jetën akademike të kolegjit, të analizojë dhe marrë parasysh propozimet dhe kontributet e tyre dhe ti bëjë ato publike (**Standardi V.5**).
9. Institucioni, të konsolidojë funksionimin e NJSBC, e cila duhet të fokusohet në mbledhjen e të dhënave, informacioneve, hartimin e dokumenteve dhe analizave e të kontribuojë në realizimin e proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që vlerësojnë performancën dhe promovojnë e përmirësojnë cilësinë në institucion (**Standardi VI.1**). (**Standardi VI.2**), (**Standardi VI.3**), (**Standardi VI.5**).

### **Conclusions of the evaluation of second cycle study program Professional Master in “Nursing management”, of University College “REALD”**

#### **Strengths and affirmations:**

1. The institution has sufficient infrastructural and logistical capacities in function of the study program for the realization of the teaching process.
2. UCR offers good opportunities for students to pursue professional internships in hospital and health centers in the Vlora region and beyond.
3. The institution has partnerships and collaborations with several institutions which, if implemented as provided in the cooperation agreements, will help the institution progress.
4. Affirmation is considered the attempt to recruit dedicated staff, but, due to the lack of qualified staff, the institution has encountered difficulties. UCR has continued it's efforts to have academic staff in line with legal requirements.

#### **Weaknesses:**

1. In its strategy, the Institution does not clearly set out the main pillars of development of study programs and areas of study and research, to be in line with the UCR's field of activity (**Standard I.2**).
2. UCR Regulations, approved in 2017, carry errors and overlaps of competences. In addition, references to prior legislation or institution information before the reorganization are identified (**Standard I.2**).
3. Although academic staff and administrators, in various ways, receive information on labor market needs in the Vlora region, there is a lack of a proper study of the labor market, new study and employment needs and opportunities (**Standard I.3**).
4. EEG understands the difficulty of the institution in its activity to have qualified staff, dedicated in every position of the structure, but on the other hand, it results that the activities carried out within the realization of academic and administrative processes in

- function of the study program, are not developed, administered, analyzed and reported in accordance with internal regulations and legislation in force (**Standard I.5**).
5. The organization, curriculum and content of the study program, are not in accordance with the sublaws in force (**Standard I.3, Standard II.1**).
  6. The head of the main unit and basic unit of technical medical sciences, are above the age limit for indefinite term employment. Furthermore, the staff with contract, has the main role in the coverage of the study program (**Standard II.2**).
  7. The institution does not have clear mechanisms for evaluating, motivating and promoting academic staff, academic support staff and administrative staff (**Standard II.5**).
  8. The design and approval of new programs and the reorganization/updating of existing programs and activities carried out during these processes are not fully documented (**Standard II.3**).
  9. The institution and the unit responsible for the study program partially document its activity (**Standard III.1**).
  10. The institution does not have a clear procedure for categorizing academic staff according to the definitions of HEL and MASR Bylaw No. 29 on teaching load in HEIs (full time/part time, professor/lecturer/assistant lecturer) (**Standard IV.1**).
  11. UCR has not developed or implemented other forms and methods of teaching and knowledge assesment, related to technology, innovative and flexible pedagogical methods, appropriate and in line with expected learning outcomes and objectives (**Standard III.4**).
  12. The institution does not have/applies an internal data and information management system which provides a range of services and functions for the administration and management of various processes and activities (**Standard IV.5**).
  13. For the study program, there is a lack of periodic financial analysis and reports presenting data on study program costs and the plan of financial support, necessary for the progress of the study program for at least one academic year (**Standard IV.6**).
  14. UCR has limited alternative financial resources in addition to student income and support from the founding company (**Standard IV.6**).
  15. The institution applies non-standardized procedures in the compilation, administration and archiving of official documentation (electronically or in paper) in accordance with the legal basis and bylaws (**Standard V.4**).
  16. Students involvement in decision making and the academic life of the college is at a low level (**Standard V.5**).
  17. The institution does not apply long-term quality assurance mechanisms but mostly ad-hoc processes and the contribution of the IQAU to external accreditation, analytical and benchmarking processes, and other processes is limited (**Standard VI.1**).
  18. The IQAU partially documents the quality assurance data. Analyzes, reporting, and suggestions/recommendations for addressing issues in the future, are not part of periodic reporting (**Standard VI.2**) (**Standard VI.3**).

19. There are no conclusions to be accompanied with action plans that address and aim to address the improvement of the identified shortcomings and weaknesses (**Standard VI.5**).

### **Recommendations:**

1. The development strategy should be updated to suit the current status of the UCR, key areas of activity, programs and implementation plan (**Standard I.2**). HEI should take into consideration the global labor market developments and science and technology developments (**Standard I.1**). UCR should review and update the Institution's internal regulatory acts in accordance with the Statute and LAL 80/2015 (**Standard I.2**).
2. The study program should be revised and reorganized within the academic year 2019 - 2020, in accordance with the bylaws, to reflect changes adopted by the Senate (VS No. 52, dated 03.10.2016) in the curriculum and the corresponding syllabuses (**Standard I.3, Standard II.1**). Within the legal framework, to consider the guidelines deriving from the EU directives for study programs in the field of Nursing Sciences (**Standard I.3**).
3. Improvement of the study program should be based on data collected from various sources, including graduate students, analyze and develop an analytical document with concrete proposals in the context of improving the study program (**Standard I.3**). Activities within the realization of academic and administrative processes for the purpose of the study program should be maintained, administered, analyzed and reported in accordance with internal acts approved by the institution and the applicable legal basis (**Standard I.5**), (**Standard II.3**).
4. Institution should continue efforts to increase the quality of full-time staff in compliance with legal obligations and quality standards (**Standard II.2**). The Institution should recruit staff with the qualification, academic-research area in accordance with the nature and specificity of the program modules and motivate/promote them in order to guarantee their long-term quality and sustainability in the institution (**Standard II.5**). Institution, should categorize employment contracts in accordance with MASR Bylaws, Labor Code, UCR regulatory acts and legal provisions of higher education law related to categories of academic staff in HEIs (**Standard IV.1**).
5. The institution should enable the use of innovative and pedagogical methods (**Standardi III.2**), to be engaged in the creation of opportunities for the continuing training of academic staff in pedagogical training (**Standard IV.2**). Structures for guaranteeing and promoting the quality of teaching, should develop specific guidelines for the development of methods and monitoring, carry out and continuously document their activity (**Standard III.1**), (**Standard III.4**), (**Standard V.4**).
6. Institution, should implement the agreements signed with foreign partners to increase the mobility of study program staff and students (**Standard III.7**).

7. UCR should take measures to guarantee income from alternative sources and ensure positive financial performance (services, projects, etc.) and to perform and compile periodic financial reports at institutional level (**Standard IV.6**).
8. Institution, should support (**Standardi V.3**), make function the Career Office (**Standard V.6**) and involve students in decision-making and academic life of the college, analyze and consider their proposals and contributions and make them public (**Standard V.5**).
9. Institution should consolidate the functioning of the IQAU, which should focus on collecting data, information, drafting documents and analysis, and contribute in the implementation of external accreditation processes, analytical and benchmarking evaluations, and other processes that evaluate performance and promote and improve quality in the institution (**Standard VI.1**), (**Standard VI.2**), (**Standard VI.3**), (**Standard VI.5**).

### III. SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT		X		
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT		X		
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE		X		
VLERËSIMI TËRËSOR		X		

#### IV. LISTA E EVIDENCAVE MBËSHTETËSE

1. Statuti i IAL (Pjesë për kriteret përkatëse)
2. Strategjia e zhvillimit të Institucionit
3. Plani strategjik për zhvillimin e programit
4. Rregullore e Përgjithshme e AL
5. Rregullore e Njesisë Kryesore
6. Rregullore e programit të studimit
7. Rregullore e NJSBC
8. Rregullore e Sekretarisë Mësimore
9. Rregullore e diplomimit
10. Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore
11. Rregullore e zyrës së Këshillimit dhe Karrierës
12. Dosja e programit të studimit
13. Modeli i diplomës (Urdhëri i aprovimit); Modeli i Suplementit të Diplomës
14. Permbushja e rekomandimeve të Vendimit të KA
15. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
16. CV e stafit akademik të programit të studimit
17. Të dhëna për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse
18. Të dhëna për personelin akademik në programin e studimit (për të gjitha vitet që programi i nënshtrohet vlerësimit)
19. Te dhenat për regjistrimin e studenteve sipas viteve akademike
20. Të dhëna tabelore për: njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në Sistemin e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë
21. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale
22. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj dhe për praktikën profesionale
23. Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombëtar
24. Marrëveshjet bashkëpunimit kombëtare 2
25. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve
26. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit
27. Raportet vjetore të publikuara për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë
28. Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional
29. Pyetësori i studentëve
30. Formular i vetëvlerësimit të performancës, stafi
31. Lista e teksteve periodike në Bibliotekë
32. Nr. programeve I dhe II të studimit që ofron Njësia Kryesore
33. Të dhëna të plota të aktiviteteve dhe kërkimin shkencor të stafit akademik
34. Formatit i dosjes personale të stafit akademik
35. Rregullore për menaxhimin e sistemit të informacionit
36. Të dhëna nga Faqja zyrtare e WEB
37. Poster për informimin e publikimit të informacionit për programet e studimit që ofrohen në IAL

38. Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional
39. Të dhëna nga Plani i financimit të programit të studimit
40. Politika e marketing-ut të programit të studimit, format e tij, transparenca me publikun
41. Rregullore e zhvillimit të provimeve
42. Buletini shkencor periodik
43. Vendim Senati Për miratimin e disa ndryshimeve të planit mësimor
44. Plani mësimor i programit të studimit "MP" në "Menaxhim infermieror" ne dy vitet e fundit.
45. Programi mesimor - Master Prof. Menaxhim Infermieror 2018-2019
46. Orari mesimor ne MP menaxhim infermieror ne dy vitet e fundit
47. Angazhimi dhe ngarkesa mësimore vjetore e personelit akademik 2017-2018 dhe 2018-2019
48. Kriteret e shperndarjes se ngarkeses se stafit
49. Programi mesimor - Master Prof. Menaxhim Infermieror 2015 - 2016
50. Te dhëna për pagesen e sigurimeve shoqerore te stafit ne IAL
51. Manuali. Regjistri i praktikës se studenteve
52. Udhezuesiper punimin e temes se diplomes
53. Shembull teme diplome ne MP ne Menaxhim infermieror
54. Akti i miratimit te temave te diplomavepdf
55. Procesverbali i diplomimeve
56. Miratimi i udheheqesve te temave te diplomave
57. KONTRATË PUNE - me kohe te plote 2018, KONTRATË PUNE - kohe e pjesshme - 2018
58. Vendim i Senatit Akademik- per miratim rregulloreve te IAL
59. Stafi Akademik i Fakultetit te Shkencave Mjekesore.pdf
60. Stafi Akademik i Departamentit te Shkencave Teknike Mjekesore
61. T1-Takimi me Dekanin dhe Pergjegjesin e Departamentit
62. T2-Takimi me GVB
63. T3- Takimi me studentet
64. T4-Takimi me Sekretarinemesimore
65. T5-Takime me Stafin Akademik
66. T6- Takim me NjSBC
67. T7-Vizita në ambientet e institucionit
68. T8-Takim me Zyren e Burimeve Njerezore (zyren e finances)
69. [www.unireald.edu.al](http://www.unireald.edu.al)
70. [www.ascal.al](http://www.ascal.al)
71. [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)
72. <http://ams.ascal.al>
73. RVB - Programi i studimit "Menaxhim Infermieror"
74. Komentet e institucionit lidhur me draft-raportin.

#### **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. As. Vjollca Durro
2. Dr. Niko Hyka